11. Pergatit informacione dhe ben analiza per tregues te vecante ekonomik e statistikor dhe jep mendime per permiresimin e punes ne te ardhmen.
12. Merr pjese ne analiza pune dhe ekonomiko-financiare te Filialit dhe jep mendime per persosjen e evidentimit te treguesve statistikor.
13. Kompjuterizon dhe harton vjetarin statistikor te shoqerise



14. Ngre probleme qe lidhen me ritjen e rentabilitetit ekonomik, per te synuar ritmet e nevojshme te zhvillimit ne sherbimet postare, telefonike e financiare.
15. Perpunon, ben grupime dhe analizon te dhena—statistikore sipas programit ekonomik-financiar te shoqerise, i pergatit dhe ia paraqet K/Degës se Statistike-Kosto-Normative prane Drejtorise Marketing, Statistike-Kosto-Normative ne periudha kohore mujore, tremujor.

SPECIALIST KOSTO- NORMATIVE

Varet dhe pergjigjet per kryerjen e detyrave te veta funksionale perpara K/Deges Perkatese dhe ka keto detyra dhe te drejta:

1. Organizon evidencen statistikore te shpenzimeve sipas grup sherbimeve per te llogaritur nje kosto reale.
2. Ndjek ne menyre periodike dhe kerkon nga zyrat, evidencat e shpenzimeve per sherbimet postare, financiare dhe transport te percaktuara sipas programit te miratuar.
3. Kryen kronometrimin dhe fotografime te proceseve te punes per cdo produkt te sherbimit ekzistues dhe njekoheisht dhe per produktet e reja
4. Llogaritje e koston per cdo produkt postar e financiar, e transport te perballueshem per klientin.
5. Propozon ne drejtorine e filialit dhe shoqerise tarifen e sherbimit per cdo produkt postar e financiar.
6. Grumbullon perpunon dhe informon, mbi gjendjen e te gjitha treguesve qe kane te bejne me koston e produktit.
7. Ndjek dhe evidenton cdo ndryshim te elementeve te koston per te pasqyruar ndryshimin ne koston e produktit, dhe informon .
8. Percakton rezultatet analitike te elementeve te koston dhe vleresimin e rezervave per cdo element te koston se produktit.

MAGAZINIER I LETRAVE ME VLERE

Varet dhe pergjigjet per kryerjen e detyrave te veta funksionale perpara K/Deges Perkatese dhe ka keto detyra dhe te drejta:

1. Te terheqe e marre ne ngarkim bazen materiale qe vjen per filialin.
2. Te beje shperndarjen e bazes materiale per zyrat postare dhe administraten ne baze te nje plan shperndarje te hartuar nga drejtori ekonomike dhe e sherbimeve.



3. Te furnizojë në kohën e duhur me materialet e nevojshme zyrat postare dhe administratën.
4. Te mbajë në rregull të gjithë regjistrat ku evidentohen hyrje-daljet e materialeve.
5. Te plotësojë me kujdes flete-hyrjet dhe flete-daljet për materialet.
6. Te bashkëpunojë me degen ekonomike për kryerjen e inventarit fizik 1 herë në vit.
7. Te raportojë në degen e shërbimeve⁶ e marketingut për gjendjen dhe sasinë e materialeve në magazine.
8. Te mbajë veprimet e hyrjes dhe daljes së pullave e hedhjen në ditarin e pullave e të taksave duke bërë rakordimin me të gjitha zyrat postare.
9. Te kryejë veprimet e hyrjes dhe daljes së kartave telefonike duke bërë rakordimin me të gjitha zyrat postare.
10. Te marrë masa për mirëmbajtjen e dokumentave të vendosura në arshive, për sigurimin në pershtatje me kushtet e ruajtjes e mbrojtjes nga demtimet, vjedhjet, zjarret.
11. Te zbatojë rregullat për hyrjen në arshive.
12. Në bashkëpunim me deget hap pasqyrat emertuese të dosjeve, sipas çështjeve përkatëse.
13. Terheq nga të gjitha deget të gjithë dokumentat që kanë mbaruar veprimtarinë praktike dhe bëjnë arkivimin e tyre.
14. Te përgatitë çdo vit listën e dokumentave që do të asgjësohen e ja paraqet atë komisionit të ekspertimit i cili vendos për asgjësimin e tyre ose jo.
15. Ruan sekretin e çdo lloji akti që hyn apo del në protokoll dhe i siguron ato në kasaforta.
16. Merr masa për kthimin në arshive të të gjithë dokumentave të hyra dhe të dala në Filial, brenda afatëve të caktuara.
17. Bën pershkrimin e plote të dosjes në kapakun e saj dhe vlerësimin e ruajtjes së dosjes duke i'u përmbytur Rregullores së Përgjithshme të Arkivave.
18. Organizon punën për vlerësimin e ruajtjes së dokumentave, për sistemin e dokumentave që kanë hyrë në arkive të pasistemuara.
19. Mban lidhje me Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave.
20. Përgjigjet për zbatimin e rregullave të arshives, organizimin dhe shfrytëzimin e saj.



DETYRAT DHE KOMPETENCAT E AUDITIT

AUDITI

Varet dhe pergjigjet per kryerjen e detyrave te veta funksionale perpara Drejtorit te Filialit dhe ka keto detyra dhe te drejta:

1. Harton programin vjetor dhe mujor te auditimit te brendshem per filialin dhe e dergon per miratim ne Drejtorine e Auditimit te Brendshem.
2. Zbaton me perpikmeri programin e auditimit te plote apo tematik ne objektin e caktuar si dhe ne afatin e cilesine e kerkuar. Kur konstaton parregullsi, shkelje te rregullave apo dispozitave ligjore mban process verbalin perkates me shkaktarin.
3. Kryen auditim te plote ekonomiko-financiar dhe te sherbimeve ne Deget e Postes dhe auditim tematik ne Zyrat Postare dhe Sportelet e Sherbimeve jo me pak se njehere ne vit.
4. Nuk shkon ne objekt pa program te miratuar nga Drejtori i Filialit.
5. Auditimi i brendshem eshte i pavarur dhe gjate auditimit zbaton standartet e auditimit te brendshem. Zbaton normat e vecanta te auditimit te hartuara nga Drejtoria e Auditimit Brendshem te Posta Shqiptare sh.a te miratuara nga Drejtori i Pergjithshem.
6. Gjate auditimit, auditimi synon korigjimin e gabimeve e praktikave inefficente dhe inkurajimin per adaptimin e praktikave me te mira, si dhe sqaron problemet me personat e audituar, kerkon dhe le detyra shume afatshkurtera per plotesim gjate kohes se auditimit te programuar me qellim qe te hidhet drite e plote per paregullsire dhe shkeljet e ligjit apo procedurave te tjera.
7. Mban lidhje te ngushte me Drejtorin e Drejtorise se Auditimit te Brendshem me Titullarin e Filialit dhe njofton here pas here per problemet e konstatuara, kerkon ndihmen e tij dhe hallkave te tjera ne Filial.
8. Per problem teknike apo ekonomike ka te drejte te kerkoje per mobilizimin e specialisteve apo te eksperteve te fusheve te ndryshme, ne raste kur ai e gjykon kerkon ndihmen e organeve te AB.
9. Ne raste kur afati i auditimit eshte i pamjaftueshem, lidhet me Drejtorin e Filialit, i paraqet arsyet dhe veshtiresite e vertetuara dhe kerkon ndihmen e nevojshme teknike si dhe shtyrjen e afatit te percaktuar ne program.
10. Ne perfundim te auditimit perpilon projekt raportin e auditimit dhe e shpreh te njohur punonjesve te filialit dhe te Drejtorise. Merr verejtjet paraprake si dhe kundershtrimet eventuale te nje problemi qe ka vend per tu diskutuar.





- dhe Brenda afatit prej 15 ditesh lidhet me drejtuesit e subjektit te audituar dhe organizon takimin pajtues (ballafaques).
11. Mbas organizimit te takimit pajtues (ballafaques) dhe dergimit zyrtar te Projekt Raportit te Auditimit, merr pjese ne takimin pajtues (ballafaques) ne objektin e audituar se bashku me Drejtorin e Filialit per auditimin e kryer nga ana e tij.
 12. Harton Raportin Final te Auditimit dhe ja dergon subjektit te audituar duke lene dhe detyra perkatese.
 13. Harton memorandumin duke trajtuar ne menyre te pambledhur paregullsite e konstatuara, cileson shkelesit e rregullave apo ligjeve si dhe, mbi bazen e shkeljeve te konstatuara, propozon ne Drejtorine e Filialit masa disiplinore dhe administrative per sejcilin prej tyre dhe le detyra per te ardhmen, duke caktuar dhe afate perkatese per eliminimin e te metave.

DETYRAT DHE KOMPETENCAT E SEKTORIT TE BURIMEVE NJEREZORE DHE ADMINISTRATES

PERGJEGJES I BURIMEVE NJEREZORE DHE ADMINISTRATES

Varet dhe pergjigjet per kryerjen e detyrave te veta funksionale perpara Drejtorit te Filialit dhe ka keto detyra dhe te drejta:

1. Studjon, ndjek, kontrollon dhe pergjigjet per zbatimin e akteve ligjore dhe nenligjore qe kane te bejne me punen dhe detyrat e Deges se Burimeve Njerezore dhe Administrative.
2. Ne perputhje me strukturen organike dhe ne bashkepunim me deget e tjera te Filialit, studjon shkallen e ngarkeses ne pune si dhe nevojat per punonjes te rinj duke bere propozime konkrete ne Drejtorine e Filialit.
3. Propozon levizje kuadri, emerime apo masa disiplinore per punonjesit qe nuk zbatojne ligjshmerine ne Drejtorine e Filialit.
4. Perpilon grafikun dhe merr pjese ne grupet e punes te ngritura nga Drejtoria e Filialit per trajnimet dhe testimet e punonjesve dhe studjon zhvillimet e karrieres se kuadrove dhe specialisteve, formimin e tyre arsimor dhe profesional, kualifikimin e tyre duke i pasqyruar ato ne dokumentat perkatese.
5. Percakton pagat e punonjesve dhe te agjenteve postare ne zyrat postare ne Qender Komune e Fshat Fundor ne baze te Vendimeve te Keshillit Mbikqyres te Shoqerise "Posta Shqiptare" S.H.A.



6. Kujdeset per trajnimin material e moral te punonjesve, dhenien e shperblimeve apo ndihmave financiare ne perputhje me fondin qe disponon ndermarrja.
7. Kujdeset per plotesimin dhe permiresimin e kushteve te punes.
8. Mban vulen zyrtare te Filialit ne vend te sigurt dhe e perdor ate vetem kur dokumenti eshte plotesuar sipas rregullave dhe vetem kur ka nenshkrimin e Drejtorit te Filialit apo personit te autorizuar posacerisht prej tij.
9. Merr masa dhe pergjigjet per pranimin, shperndarjen dhe nisjen e korespondences zyrtare.
10. Ruan sekretin e çdo lloj akti qe kryen apo del ne protokoll dhe i siguron ato ne kasaforte.
11. Pranon dokumenta qe hartohen nga Filiali ne aq kohe sa duhen per t'ju derguar subjekteve ne adresat e parashikuara dhe nje kopje mbahet per tu arkivuar. Vulosen vetem ato qe dalin jashte Filialit dhe organizon punen e pergjigjet per nisjen e rregullt ne kohe te tyre.
12. Çdo fillim viti hap librat e rinj te korespondences ne te cilat regjistroin te gjitha shkresat e hyra dhe te dala duke zbatuar rregulloren.
13. Protokollon dhe ruan te gjitha Urdherat e dala nga Drejtoria Filialit.
14. Dorezon prane specialistit te Arshives teresine e dokumentave te vitit te kaluar, brenda 6-mujorit te pare te vitit ushtrimor, duke verifikuar teresine fizike te tyre dhe duke i spontuar ato ne regjistrin e korespondences.
15. Organizon punen e pergjigjet per nisjen e postes ne kohe. Ne kopjen qe mbahet ne arshive shenohet emri i konceptuesit.
16. Ploteson dhe sistemon librezat e punes se punonjesve si dhe ploteson rregullisht regjistrin themeltar me te dhenat perkatese te kerkuara mbeshitetur kjo edhe ne dispozitat ligjore ne fuqi.
17. Ploteson, freskon dhe pasuron dosjet personale te te gjithe punonjesve, rregjistrin themeltar sipas ligjeve dhe vendimeve ne fuqi.
18. Harton grafikun e lejeve te zakonshme te punonjesve ne strukture dhe fuqi punetore duke marre mendimin e Degeve dhe Kryetareve te Zyrave dhe ja propozon ato Drejtorit te Filialit per miratim ne perputhje me Kontraten Kolektive te Punes.
19. Pergatit dhe perpunon evidencat e pagave te punonjesve te Filialit dhe ato te Degeve, evidencat e tjera mujore, 3-mujore, 6-mujore, vjetore ne lidhje me treguesit e kerkuar e i çon ne Drejtorine e Pergjithshme ne afatet kohore te duhura.
20. Kontrollon zbatimin e disiplines ne pune, ne Filial, ne Dege dhe ne zyrat postare e deri ne sportel, etiken e sjelljes ndaj klientit dhe paraqitjen e punonjesve me uniforme gjate orarit te punes.



21. Ndjek ne menyre sistematike levizjet e punonjesve neper sportelet e pranimit sipas nje grafiku te percaktuar me pare dhe dergon per kete informacion ne Drejtorine e Pergjithshme.
22. Organizon pritjen dhe percjelljen e qytetareve per probleme te ndryshme ne Drejtorine e Filialit.
23. Pergatit liste prezencat, grumbullon raportet mjekesore dhe urdher sherbimet e punonjesve te administrates se Filialit duke i cuar per firme tek Drejtori i Filialit dhe me pas i percjell ne Degen Ekonomike e cila ben likuidimin e tyre.
24. Ndjek ne vazhdimesi te dhenat mbi punonjesit e Filialit nepermjet informatizimit te tyre nepermjet Databases te Programit per Burimet Njerezore.

KRYETARE ZYRE QENDER QYTETI

Varet dhe pergjigjet per kryerjen e detyrave te veta funksionale perpara Drejtorit te Filialit dhe Deges se Sherbimeve e Marketingut dhe ka keto detyra dhe te drejta:

1. Organizon, drejton punen ne administrimin e zyres postare qender qyteti
2. Organizon shperndarjen e fuqise puntore ne sportel dhe komisionet e perpunimit ne zyrën postare.
3. Organizon vijimin normal te dergesave postare nga zyra postare ne Filialin e Postes Sh.A Qendra Tranzite.
4. Mban qendrim per çdo shkelje te regullave te punes e te kryerjes se sherbimeve dhe informon K/Deges Sherbimeve e Marketingut.
5. Ndjek dhe merr masa per forcimin e disiplines ne pune ne sportelin e pranimit dhe sektoret e perpunimit.
6. Organizon analizat ekonomiko financiare te punes ne zyrën postare, duke marre masa per permirsimin e cilesise se sherbimeve postare, financiare, biznes dhe te perpunimit.
7. Organizon punen per hartimin e projekt programeve dhe programeve vjetore te treguseve ekonomiko financiar te zyres postare sipas sporteleve.
8. Bashkrendon punen me te gjithë klientet duke kontaktuar dhe zbatuar kontratat e lidhura dhe ben çdo muaj akt rakordimet me to.
9. Organizon punen per kompletimin e sporteleve te sherbimit dhe sektorin e perpunimit me bazen e nevojshme materiale teknike per kryerjen e sherbimeve, konforme kushteve e standarteve te percaktuara nga Posta Shqiptare.



10. Teston, analizon e zgjidh ankesat e klienteve per sherbimin, duke marre, masat perkatese per permirsimin, korigjimin e mangesive dhe te metave duke nxjerre pergjegjesite perkatese.
11. Zbaton me korrektese detyrat qe i ngarkojne eproret dhe drejtuesit e Filialit.
12. Mban pergjegjesi dhe pergjigjet per plotesimin e detyrave funksionale ne sasine, cilesine e afatin e caktuar.
13. Ne fund te çdo 15- diteshi dorëzon liste prezencat e punonjesve ne vartesi te tij.
14. Planifikon pushimet dhe lejet vjetore te punonjesve.
15. Organizon punen per zevendesimin e tyre me numerin e nevojshem te punonjesve.

Liad



RREGULLORE E BRENDESHME

POSTA SHQIPTARE SH.A

FILIALI POSTES SH.A TIRANE

1. Qellimi i rregullores

Drejtoria e Shoqerise, mbeshtetur ne dispozitat e Legjislacionit Shqiptar, te atij Postar si edhe mbeshtetur ne udhezimet e Keshillit te Ministrave harton rregulloren per te gjitha Filialet jashte Kategorie, ku jane percaktuar te gjitha te drejtat dhe detyrat funksionale per çdo vend pune . Zbatimi i kesaj rregulloreje eshte i detyrueshem per te gjithë punonjesit e ketij filiali.

Hyrja ne fuqi

Rregullorja “ Per organizimin dhe funksionimin e Filialit te Tiranes te Posta Shqiptare “ Sh.A, hyn ne fuqi me miratimin e saj nga Keshilli Mbikqyres .

2.STRUKTURA ORGANIZATIVE

Strukturat organizative te Filialit te Postes Tirane, propozohen nga Drejtoria e Pergjithshme dhe miratohen nga Keshilli Mbikqyres i Shoqerise te “ Posta Shqiptare “ SH.A.

Emerimi i Drejtorit dhe N/ Drejtorit te Filialit behet me Vendim te Drejtorise se Pergjithshme te “ Posta Shqiptare “ SH.A .

Punonjesit e tjere sipas struktures , miratohen nga Drejtoria e Pergjithshme e Shoqerise mbi bazen e propozimit te Drejtorise se Filialit.

Emerimi ne detyre per fuqine punetore eshte kompetence e Drejtorise se Filialit.



DETYRAT DHE KOMPETENCAT E DREJTORIT TE FILIALIT

DREJTORI I FILIALIT

Drejtori i Filialit emerohet nga Drejtoria e Pergjithshme e "Posta shqiptare" S.H.A dhe pergjigjet perpara saj. Ka ne kompetence te tij keto detyra kryesore :

1. Organizon, drejton, programon, bashkerendon dhe pergjigjet perpara Drejtorit te Pergjithshem drejtpersedrejt per mbarvajtjen, zhvillimin, zgjerimin dhe ngritjen cilesore e sasore te sherbimeve postare e financiare etj ne qark dhe dege.
2. Organizon dhe drejton gjithc aktivitetin ekonomik - financiar, mbarvajtjen e sherbimeve ne te gjithc Filialin dhe deget ne varesi.
3. Organizon e drejton analizat periodike ekonomik-financiare te Filialit.
4. Drejton dhe organizon punen per hartimin e projekt-programit ekonomik financiar dhe projektin per treguesit normative e cilesore te sherbimeve net e gjithc treguesit e tyre dhe e prezanton ate ne Drejtorine e Shoqerise per miratim dhe pas miratimit organizon detajimin dhe zbatimin e ketij programi.
5. Organizon dhe drejton punen per zgjerimin e zhvillimin e sherbimeve postare dhe financiare.
6. Organizon punen per raportimin ne kohe, saktesi dhe cilesi te detyrave qe caktohen nga Drejtoria e Shoqerise si dhe organet e tjera me te larta.
7. Ben zberthimin e programit ekonomik - financiar te miratuar, per deget e zyrat ne vartesi, duke ndjekur ne dinamike realizimin e tij.
8. Lidh mardhenie kontraktuale ne mbeshtetje me kopetencat qe i jane miratuar nga Drejtoria e Shoqerise me personat fizike e juridike per realizimin e detyrave te ngarkuara si dhe ndjek realizimin ne cilesi, sasi e lloj te tyre sherbimeve, mallrave e punimeve qe ka ne kopetence filiali.
9. Organizon kontrollin e zbatimit te programit ekonomik-financiar, rregulloret e sherbimeve postare dhe financiare, cilesine, shpejtesine e saktesine e tyre si dhe zbatimin e drejte e ne kohe te vendimeve, urdheresave e udhezimeve ne fuqi.
10. Organizon dhe pergjigjet per miradministrimin e vlerave materiale e monetare, sherbimin statistikor dhe kontabilitetin ne Filial dhe Dege ne perputhje te plote me aktet ligjore e nenligjore ne fuqi.
11. I propozon Drejtorise se Shoqerise hapjen e zyrave te reja postare si dhe reformimin dhe modernizimin e tyre.
12. Bazuar ne propozimin e N/Drejtorit te Filialit, i percjell Drejtorise se Pergjitheshme per miratim strukturen organizative te Filialit dhe

- kategorite e Degeve e zyrave qe mbulon , bazuar ne kriteret e miratuara nga Keshilli Mbikqyres i Shoqerise .
13. Bazuar ne propozimin e N/Drejtorit te Filialit, i percjell Drejtorise se Shoqerise kandidatet per emerime ne vendet vakante.
 14. Bazuar ne propozimin e N/Drejtorit te Filialit, i percjell Drejtorise se Shoqerise dhenien e masave disiplinore si dhe largimet nga puna per punonjesit ne administraten e tij.
 15. Ne rast delegimi te fondeve limit nga Drejtoria e Pergjithshme , drejtuesi i Filialit merr persiper kryerjen e procedurave te prokurimit.
 16. Siguron bashkpunim e bashkeveprim me partneret kryesore, Kesh, Albtelekom, I.S.K.SH, etj ne qark per mirfunksionimin e aktiviteteve te sherbimeve postare dhe financiare.
 17. Pergjigjet per derdhjet ne kohe te detyrimeve ndaj Buxhetit te Shtetit, Sigurimeve Shoqerore si dhe Tatim -Taksave te tjera te detyruara me aktet ligjore e nenligjore.
 18. Bashkepunon dhe bashkerendon punen me strukturat e tjera te Filialit dhe Deges dhe pergjigjet perpara Drejtorit te Filialit per mbarvajtjen, zgjerimin dhe ngritjen cilesore e sasiore te sherbimeve postare e financiare ne Filial e Dege.
 19. Ndjek ne vazhdimesi mbarevajtjen e punes te Deges se Perpunim – Shperndaresise.
 20. Organizon punen per administrimin dhe ruajtjen e arkivit te Filialit, si dhe pergjigjet per mirzbatimin e rendit te brendshem ne pune per forcimin e disciplines dhe ruajtjen e administrimit te vlerave monetare, dokumentare e materialeve konforme rregullores perkatese si dhe akteve ligjore e nenligjore ne fuqi.
 21. Organizon kontrolle te befasishme tematike si dhe miraton, ndjek e analizon programet e kontrolleve te befasishme ne Filiale dhe Dege.
 22. Therret ne raport sipas problemeve te gjithe punonjesit e varesise ne Filial dhe Dege dhe sipas pergjegjesive e pasojave, propozon masat perkatese per miratim ne Drejtorine e Pergjitheshme te Shoqerise ne perputhje me Kontraten Kolektive dhe Kodin e Punes.
 23. Nxjerr urdhera, udhezime e qarkore te brendeshme ne zbatim e funksion te rregullores se brendshme te Postes Shqiptare sh.a.



DETYRAT DHE KOMPETENCAT E ZEVENDES DREJTORIT TE FILIALIT

ZEVENDES DREJTORI

Zevendes Drejtori i Filialit emerohet nga Drejtoria e Pergjithshme e "Posta Shqiptare" S.H.A. Varet nga Drejtori i Filialit dhe pergjigjet para tij. Ka ne kompetence te tij keto detyra kryesore:

1. Trajton problemet administrative te funksionimit dhe te zhvillimit te administrates dhe Burimeve Njerezore, Sigurimit, Cilesise dhe Marketingut te cilat i ka ne varesi te drejteperdrejte.
2. Organizon punen per zbatimin me korrektesi te plote te struktures organizative ne Filial, plotesimin e organikave me punonjes te pershtatshem sipas aftesive, nivelit dhe profilit arsimor duke bere respektimin e tabelave se pagave te miratuara nga Keshilli Mbikqyres.
3. Eshte kryetar i komisionit te testimi te kandidaturave per punesim duke bere perzgjedhjen e tyre dhe pergjigjet per rekrutimin dhe kualifikimin e Burimeve - Njerezore.
4. Miraton ne parim strukturen organizative te Filialit dhe kategorite e Degeve e zyrave qe mbulon, ne perputhje me kriteret e miratuara nga Keshilli Mbikqyres i Shoqerise.
5. I propozon Drejtorit te Filialit kandidatet per emerimet ne vendet vakante, te cilet pas miratimit ne parim nga Drejtoria e Filialit i dergohen per miratim Drejtorise se Shoqerise.
6. Ne bashkepunim me Degen e Burimeve Njerezore i propozon Drejtorit te Filialit dhenien e masave disiplinore si dhe largimet nga puna per punonjesit, te cilat pas miratimit ne parim nga Drejtoria e Filialit i dergohen per miratim Drejtorise se Shoqerise.
7. Ne bashkepunim me Drejtorine e Burimeve Njerezore prane Drejtorise se Pergjitheshme punon per kualifikimin e punonjesve te saj nepermjet kurseve dhe seminareve te ndryshme qe organizohen sipas specifikave perkatese per te gjitha llojet e sherbimeve.
8. Ndjek analizat periodike ekonomiko-financiare te Drejtorive, Degeve dhe sektoreve te Filialit dhe relaton te Drejtori i Filialit per problemet kryesore.
9. Organizon punen per raportimin ne kohe, saktesi dhe cilesi te detyrave qe caktohen nga Drejtoria e Filialit dhe organet e tjera me te larta.

10. Organizon dhe pergjigjet para Drejtorit te Filialit per sigurimin e vlerave materiale e monetare dhe sherbimin statistikor ne Filial dhe Dege ne perputhje te plote me aktet ligjore e nenligjore ne fuqi.
11. I propozon Drejtorit te Filialit hapjen e zyrave te reja postare si dhe reformimin dhe modernizimin e tyre.
12. Harton dhe propozon strategjine e Filialit per mardheniet publike dhe ato me median per reklamimin dhe tregtimin e te gjitha sherbimeve postare e financiare qe kryen "Posta Shqiptare" Sh.A.
13. Ne bashkepunim me gazeten Postieri reklamon punen e Filialit dhe Deges ne varesi.
14. Pergjigjet per disipinen ne pune dhe mirembajtjen e ambienteve te punes brenda standarteve te sherbimeve qe ofrohen.
15. Siguron bashkepunim e bashkeveprim me institucionet e tjera per mirefunksionimin e aktiviteteve te sherbimeve postare dhe financiare dhe relaton te Drejtori i Filialit per mbarevajtjen e tyre.
16. Organizon kontrolle te befasishme tematike ne baze te nje programi te miratuar, ndjek, analizon dhe relaton te Drejtori i Filialit rezultatet e kontrolleve te befasishme ne Filial dhe Dege.

DETYRAT DHE KOMPETENCAT E DREJTORISE SE SHERBIMEVE

DREJTORI

Varet dhe pergjigjet per kryerjen e detyrave te veta funksionale perpara Drejtorit dhe
Zv/Drejtorit te Filialit dhe ka keto detyra dhe te drejta:

1. Organizon, ndjek, kontrollon dhe pergjigjet per ecurine e sherbimeve postare, financiare dhe bankare ne Filialin e Postes Tirane. Drejton anen metodologjike te kryerjes se ketyre sherbimeve ne deget, sektoret dhe zyrat postare ne vartesi te filialit.
2. Ndjek dhe kontrollon zbatimin e rregullores se sherbimeve ne deget, sektoret e zyrat postare, udhezimet e dala nga Drejtoria e Shoqerise per zbatimin e marveshjeve e kontratave te lidhura me kompani, firma e organizata te ndryshme.
3. Ndjek e kontrollon hartimin e programeve mujore te punes se degeve dhe te sektoreve qe ka ne vartesi.
4. Merr pjese ne hartimin e programit ekonomik -financiar te filialit dhe mbas miratimit organizon punen per detajimin e tij.
5. Pergjigjet per realizimin e treguseve te miratuar te programit, per cdo dege sektor e zyre postare.



6. Ndjek realizimin e treguseve ekonomike dhe te sherbimeve ne menyre periodike.
7. Analizon çdo muaj progresivisht gjendjen aktuale te sherbimeve, tendencat, faktoret dhe prespektiven e sherbimeve.
8. Analizon inardheniet reciproke me partneret, perfitimet dhe problemet.
9. Ben perpjekje per marrjen e sherbimeve te reja dhe analizon nese ka sherbime te humbura, faktoret qe kane ndikuar dhe mundesite per rikuperim.
10. Organizon kontrole te pavarura dhe nen grup pune percilesine e kryerjes se sherbimeve ne filialin e Postes Tirane.
11. Ne bashkpunim me deget e sektorit studion ngarkesen per çdo zyre postare apo vend pune dhe mbi bazen e rezultateve te nxjerra ben propozimin per hapjen ose mbylljen e zyrave postare ne qytet, qender komune e fshat fundor, per shtimin ose shkurrimin e vendeve te punes me qellim permirsimin e treguseve ekonomiko -financiar dhe ato cilesor te filialit.
12. Organizon punen ne kete Drejtori per realizimin e detyrave.
13. Siguron zbatimin e ligjshmerise dhe rregullave te percaktuara per administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale dhe monetare.
14. Mban lidhje te rregullta me Drejtorine e Shoqerise per problemet qe dalin ne lidhje me zbatimin e ligjshmerise financiare, administrimin e pasurise se filialit per parandalimin e veprimeve qe jane ne kundërshtim me statusin e Shoqerise dhe dispozitat ligjore ne fuqi.
15. Ne bashkepunim me deget operative ne filial punon per hartimin e projekt-programit ekonomiko-financiar me synim marrjen e te ardhurave paksimit e shpenzimeve.
16. Jep udhezime metodologjike ne fushen e programimit ekonomik, merr pjese ne analiza pune, ekonomiko-financiare, tremujore, gjashtemujore nentemujore, vjetore per plotesimin e detyrave te caktuara ne programet ekonomiko-financiare.
17. Pergjigjet per dergimin ne afat e me cilesi te te gjitha te dhenave te percaktuara (bilancin vjetor e ate periodik, evidencen e realizimit te te ardhurave ,shpenzimeve ,fitimit) si dhe per çdo te dhene tjeter qe kerkohet nga Shoqeria.
18. Pergjigjet per zbatimin e planit kontabel dhe udhezimeve te derguara nga Shoqeria per kete qellim.
19. Organizon dhe drejton punen per nxjerrjen e bilancit kontabel ne afatet e caktuara duke pergatitur relacionin shpjegues.
20. Ndjek zbatimin e tarifave e çmimeve te derguara nga Shoqeria.
21. Ndjek ne vazhdimesi gjendjen e debi-kredive i analizon çdo tremujor duke percaktuar dhe masa per paksimin e tyre.

22. Organizon punen per kryerjen e gjithe inventareve fizike (nje here ne vit) duke propozuar perberjen e komisioneve si dhe komisionin e asgjesimit te materialeve qe propozohen e miratohen per jashte perdorimit.
23. Mban ditarin e pergjithshem te mjeteve kryesore dhe ben llogaritjen e amortizimit tremujor e vjetor.
24. Pergatit relacionin, pasqyrat permbledhese te rezultateve te inventarizimit dhe ja percjell Drejtorise se Shoqerise me sistemimin e propozimeve te materialeve per jashte perdorimit.
25. Ne mbeshetje te Udhezimit nr.3, date 19.02.1996 te K.M. "Per blerjet me vlera te vogla " kryen detyren e kryetarit te komisionit me komisionin e miratuar nga titullari i Filialit duke pergatitur urdher prokurimi.
26. Organizon punen per ndjekjen e rakordimeve mujore te kryera nga dega e sherbimeve ne zbatim te kontratave te lidhura me kliente te ndryshem , si dhe ndjekjen e detyrimeve reciproke qe lindin ne zbatim te tyre.
27. Zbaton te gjitha detyrat qe merr nga Shoqeria dhe Drejtori i filialit.

K/DEGES SHERBIMEVE POSTARE

Varet dhe pergjigjet per kryerjen e detyrave te veta funksionale perpara Drejtorit Perkates dhe ka keto detyra dhe te drejta:

1. Organizon, drejton, kontrollon dhe pergjigjet per ecurine e sherbimeve postare si dhe telefonise brenda Filialit Tirane ne perputhje me rregullat e miratuara dhe udhezimeve qe jepen nga Drejtoria e Pergjitheshme sh.a.
2. Ndjek e kontrollon zbatimin e Rregullores se Sherbimit Baze Postar si dhe te gjitha urdherat dhe udhezimet qe dergohen nga Posta Shqiptare sh.a ne dege, sektore e zyra postare te Filialit Tirane.
3. Drejton punen per hartimin e programit te sherbimit postar, dhe telefonise, ne natyre e vlere sipas llojeve te sherbimeve postare te Filialit dhe ben detajimin e tij per çdo zyre postare.
4. Drejton anen , tekniko-profesionale, cilesine e kryerjes se sherbimeve te reja postare ne dege e zyra postare te filialit.
5. Merr pjese ne trajnimin dhe testimin e punonjesve te zyrave postare.
6. Ndjek realizimin e treguesve ne menyre periodike te te gjithe zerave te sherbimit postar, si dhe telefonise ne natyre e ne vlere.
7. Organizon kontrole per cilesine e sherbimit postar, lidhur me pranimin, vijimin e objekteve postare e kolipostare ne dege e zyra ne vartesi te Filialit.
8. Ne bashkepunim me sektore te tjere te sherbimeve studjon ngarkesen per çdo zyre ose vend pune dhe mbi bazen e rezultateve te nxjerra ben



- propozimin për hapjen ose mbylljen e zyrave postare, shtimin ose shkurtimin e vendeve të punës me qëllim përmirësimin e tregut ekonomike dhe ato cilësore të filialit.
9. Në bashkëpunim me filialin e tranzitit harton grafikun e levizjes së dërgesave postare nga zyrat postare të filialit dhe merr masa për ndjekjen dhe zbatimin me korekta të tij.
 10. Merr pjesë në grupet e punës të ngritura nga Drejtoria e Shoqërisë apo Drejtoria e Filialit për probleme të veçanta të shërbimit postar, si dhe njihet me të rejtat në shërbimin postar.
 11. Përgatit informacione dhe relacionet përkatëse për aktivitetin në sektorin postar dhe i bën prezente në Drejtorinë e shërbimit postar.
 12. Ndjek dhe kontrollon zbatimin e tarifave të shërbimit postar në sportele e zyra postare në filial dhe dege në vartësi.
 13. Mban lidhje me dege dhe zyra postare të filialit për mbarrvajtjen e punës në shërbimin postar dhe ndihmon në zgjidhjen e problemeve që dalin.
 14. Ndjek dhe kontrollon të gjitha problemet që kanë të bëjnë me vezhgesat për objektet postare e kolipostare në zyrat postare të filialit dhe përcakton afatet kohore të përcaktuara në Rregulloren e Shërbimit Postar.
 15. Mban lidhje të vazhdueshme me deget dhe zyrat postare në vartësi për zgjidhjen e ankesave të klienteve dhe problemeve që dalin për shërbimin postar.
 16. Organizon pyetësore dhe anketime për probleme të ndryshme të shërbimit.
 17. Mbi bazën e konkluzioneve të dalura nëpërmjet punës me klientët, reklamacionet e pyetësorët jep mendim për përmirësimin e shërbimit postar.
 18. Ushton kontrolle në dege e zyra postare për reklaminin e shërbimeve.
 19. Përcakton, në bazë të vezhgimit të zhvillimeve në treg, nevojat për shërbime dhe produkte të reja postare dhe ndihmëse apo përmirësimin e atyre ekzistues.
 20. Miraton e kontrollon zbatimin e grafikut të pagesës së pensioneve për çdo zyrë postare si dhe ato të pagesës deri me derë duke propozuar masa për përmirësimin e punës duke patur si qëllim përmirësimin e cilësive të shërbimit.
 21. Bën përpjekje për ritjen e cilësive të shërbimit postar të shpërndarjes së pensioneve në familje brenda filialit dhe kryen kontrolle të organizuara e të befasishme në zyrat postare në vartësi të filialit.
 22. Ndjek ankesat e klienteve dhe probleme të veçanta të shërbimit të pensioneve në shtëpi si dhe merr masa për zgjidhjen e tyre.

23. Mban lidhje me zyra postare te filialit per mbarvajtjen e punes ne sherbimin postar te pensioneve ne shtepi dhe ndihmon ne zgjidhjen e problemeve.
24. Ndjek realizimin e treguesve ekonomik te te gjitha zerave te sherbimit postar te pensioneve ne shtepi per cdo muaj ne natyre e ne vlere.

SPECIALIST I SHERBIMIT POSTAR

Varet dhe pergjigjet per kryerjen e detyrave te veta funksionale perpara Drejtorit dhe K/Degetes Perkates dhe ka keto detyra dhe te drejta:

1. Varet nga K/Degetes sherbimit postar dhe zbaton te gjitha detyrat e ngarkura prej tij.
2. Ndjek zbatimin e Rregullores se Sherbimit Baze Postar si dhe te gjitha urdherave dhe udhezimeve qe dergohen nga Posta Shqiptare sh.a.(Drejtoria e Sherbimit Postar).
3. Ben perpjekje per ritjen e cilesise se sherbimeve postar, EMS,EBQ dhe ENQ dhe kryen kontrolle te organizuara e te befasishme ne deget dhe zyrat postare ne vartesi te Filialit.
4. Ndjek realizimin e treguesve ekonomik te te gjitha zerave te sherbimeve postar, EMS,EBQ dhe ENQ ne natyre e ne vlere.
5. Kontrollon zbatimin e urdherave dhe udhezimeve qe dergohen nga Posta Shqiptare sh.a. ne dege e zyra postare te Filialit Tirane per sherbimeve postar, EMS,EBQ dhe ENQ.
6. Ndjek dhe kontrollon zbatimin e tarifave te EMS, EBQ dhe ENQ., ne sportele e zyra postare ne filial e dege ne vartesi.
7. Mban lidhje me zyra postare te filialit per mbarvajtjen e punes ne sherbimet qe ndjek dhe ndihmon ne zgjidhjen e problemeve.
8. Ndjek ecurine e sherbimit te Llotarise Amerikane ne periudhen Tetor-Dhjetor te cdo viti.
9. Ushtron kontrolle ne dege e zyra postare per reklaminin e sherbimeve .
10. Ndjek dhe harton proces-verbalin mujor me Albtelekomin per shlyerjen e detyrimeve per sherbimin telefonik.
11. Ndjek reklamacionet te hyra dhe e dala per sherbimin e shpejte dhe te EMS.
12. Kontrollon zbatimin me korrektese te grafikut te vijimit te postes se shpejte nga zyrat postare per ne sektorin e EMS.
13. Ndjek ankesat e klienteve dhe probleme te vecanta te sherbimit postar ekspres dhe te EMS si dhe merr masa per zgjidhjen e tyre.
14. Mban lidhje me zyra postare te filialit per mbarvajtjen e punes ne sherbimin postar ekspres dhe te EMS dhe ndihmon ne zgjidhjen e problemeve.



15. Punon dhe ndjek implementimin e kodit postar per Filialin e Tiranës.

SPECIALIST I ZYRAVE POSTARE:

Varet dhe pergjigjet per kryerjen e detyrave te veta funksionale perpara Drejtorit Perkatës dhe K?Degës dhe ka keto detyra dhe te drejta:

1. Te siguroje mbarvajtjen e punes ne zyrat postare te qytetit dhe fshatit.
2. Te organizoje shperndarjen e fuqise puntore ne bashkepunim me degen e Burimeve Njerezore te filialit ne funksion te sherbimit.
3. Te organizoje punen per furnizimin normal te zyrave postare te filialit me formulare te sherbimit, letra me vlere kancelari dhe artikuj biznesi per funksionimin normal te sherbimit
4. Te ushtroje ne bashkpunim me sektoret e sherbimeve kontrole te programuara dhe te befasishme ne lidhje me funksionimin e sherbimeve, cilesine dhe disiplinën ne pune.
5. Te organizoje punen dhe te ndjeke dorezimin ne kohe te evidencave mujore te treguesve ekonomiko-financiar e cilesor te sherbimeve.
6. Te evidentoje dhe te dorzoje liste prezencat e paraqitjes ne pune te punonjesve te te gjithe zyrave postare te filialit.
7. Te kontrolloje sipas nje grafiku te miratuar nga Drejtoria e filialit zbatimin e orarit te punes ne zyrat postare.
8. Te perpiloje grafikun e lejeve te zakonshme, ta miratoje ate ne Drejtorine e filialit dhe te ndjeke zbatimin e tij.
9. Te marre masa per zevendesimin e punonjesve te sherbimit ne rast mungesash (leje, raporte, mungesa pa arsye etj).
10. Te marre masa dhe te propozoje prane Drejtorise se filialit per plotesimin me bazen e nevojshme materiale per ecurine normale te sherbimit.
11. Te organizoje ne bashkpunim me sektoret e sherbimit te filialit analiza ekonomiko financiare te punes me punonjesit e zyrave duke marre masa per permirsimin dhe ritjen e efektivitetit te sherbimeve.
12. Te ndjeke sistematikisht shperndarjen e faturave te abonenteve telefonik te Albtelekom nr.1 Albtelekom nr.2 ne te gjithe zyrat postare te filialit dhe te dorzoje prane sektorit te sherbimit financiar ngarkesen e faturave te ardhur me proces verbal (e cila firmoset nga punonjeset e zyrave.)
13. Te harroje qarkore per problemet e krijuara gjate sherbimeve dhe ne kontakt me klientet.
14. Te ndjeke ankesat e klienteve, te zgjidhen dhe te merren masat perkatese per korrigjimin e problemeve, duke nxjerre dhe pergjegjesite perkatese

15. Ne bashkpunim me degen e sherbimeve te punoje ne drejtim te rritjes se nr.te veprimeve per sherbimet postare e financiare nepermjet thithjes se sherbimeve te reja.
16. Te mbaje qendrim per çdo shkelje te Rregullores se sherbimit Postar, Financiar dhe disiplines ne pune.
17. Merr pjese ne grupet e punes te ngritura nga Drejtoria e Filialit per probleme te veçantate te sherbimit dhe njihet e ben perpjekje per zgjerimin e njohurive per sherbimet e reja.
18. Te ndjeke vazhdimisht vijimin e dergesave postare nga zyrat postare ne Filialin Qendra Tranzite.

KRYETARI I ZYRES POSTARE NR. 5

Varet dhe pergjigjet per kryerjen e detyrave te veta funksionale perpara Drejtorit Perkatës dhe Pergjegjesit te Sektorit Perkatës dhe ka keto detyra dhe te drejta:

1. Organizon, drejton punen ne administrimin e zyres postare nr.5
2. Organizon shperndarjen e fuqise puntore ne sportel dhe komisionet e perpunimit ne zyren postare nr.5
3. Organizon vijimin normal te dergesave postare nga zyra postare nr.5 ne Filialin e Tranzitit.
4. Mban qendrim per çdo shkelje te regullave te punes e te kryerjes se sherbimeve dhe informon pergjegjesen e zyrave postare te filialit.
5. Ndjek dhe merr masa per forcimin e disiplines ne pune ne sportelin e pranimit dhe sektoret e perpunimit.
6. Organizon analizat ekonomiko financiare te punes ne zyren postare nr.5.
7. Duke marre masa per permirsimin e cilesise se sherbimeve postare,financiare,biznes dhe te perpunimit.
8. Organizon punen per hartimin e projekt programeve dhe programeve vjetore te treguseve ekonomiko financiar te zyres postare nr.5 sipas sporteleve.
9. Bashkrendon punen me te gjithë klientet duke kontaktktuar dhe zbatuar kontratat e lidhura dhe ben çdo muaj akt rakordimet me to.
10. Organizon punen per kompletimin e sporteleve te sherbimit dhe sektorin e perpunimit me bazen e nevojshme materiale teknike per kryerjen e sherbimeve, konforme kushteve e standarteve te percaktuara nga Posta Shqiptare.
11. Teston, analizon e zgjidh ankesat e klienteve per sherbimin, duke marre, masat perkatese per permirsimin,korigjimin e mangesive dhe te metave duke nxjerre pewrgjegjesite perkatese.



12. Zbaton me korrektese detyrat qe i ngarkojne eproret dhe drejtuesit e Filialit.
13. Mbar. pergjegjesi dhe pergjigjet per plotesimin e detyrave funksionale ne sasine, cilesine e afatin e caktuar.
14. Ne fund te cdo 15- diteshi dorezon liste prezencat e punonjesve ne vartesit te tij.
15. Planifikon pushimet dhe lejet vjetore te punonjesve.
16. Organizon punen per zevendesimin e tyre me numerin e nevojshem te punonjesve.

SPECIALIST ZYRES POSTARE NR.5

Varet dhe pergjigjet per kryerjen e detyrave te veta funksionale perpara Drejtorit Perkates dhe Pergjegjesit te Sektorit Perkates dhe ka keto detyra dhe te drejta:

1. Ben kordinimin e programit universal
2. Ben hapjen dhe mbylljen e programit universal sipas nje turni, jep autorizimin per cdo sportel, per fillimin e e punes.
3. Ben furnizimin e e punonjesve me baze materiale
4. Njofton eproret per parregullsire ne mbarevajtjen e sherbimit.
5. Mbyll evidencat ditore duke printuar sipas llojeve te sherbimeve
6. Perpilon evidencat mujore dhe ben rakordinimin perfundimtar ne degen e statistikes
7. Ne fund te muajit ben rakordinimin me institucione te ndryshme.

K/DEGES SHERBIMIT FINANCIAR

Varet dhe pergjigjet per kryerjen e detyrave te veta funksionale perpara Drejtorit Perkates dhe ka keto detyra dhe te drejta:

1. Organizon, drejton, kontrollon dhe pergjigjet per ccutine e sherbimeve financiare ne Filial.
2. Organizon dhe menaxhon aplikimin dhe kryerjen e sherbimeve te reja financiare ne Filial.
3. Studion marveshjet e rregulloret e ndryshme per sherbimet financiare dhe harton qarkore dhe udhezime per zbatimin e tyre ne zyrat postare te Filialit.
4. Programon dhe ndan detyrat vartesve te saj dhe ndjek e kontrollon zbatimin e tyre.
5. Harton se bashku me vartesit programin ekonomiko-financiar te sherbimeve financiare duke bere zberthimin per cdo zyre postare sipas zerave kryesore te sherbimeve.

6. Ndjek e analizon ecurine dhe realizimin e treguesve te sherbimit financiar ne menyre periodike çdo 10 ditor, mujor,3-mujor e progresiv sipas zerave te ketij sherbimi.
7. Organizon e kryen studime mbi ngarkesen ne pune te cdo punonjesi, sporteli-sherbimi e zyre postare. Mbi bazen e ketyre studimeve ben propozime per permiresimin e sherbimit, rritjen e efektivitetit te sherbimeve duke synuar rritjen e cilesise se kryerjes se sherbimit me sa me pak shpenzime e fuqi puntore.
8. Ne bashkepunim me drejtorine e Filialit organizon dhe menaxhon aplikimin e sherbimeve te reja financiare.
9. Organizon e ushtron kontroll per realizimin e treguesve, cilesine dhe propogandimin e sherbimimeve financiare ne Filialin e Postave Tirane. I dokumenton ato nepermjet akt-kontrolleve, proces-verbaleve ose njoftimeve me shkrim per Drejtorine e Sherbimeve Bankare dhe Financiare ose per Drejtorin e Filialit te Postes Tirane. Kontrollat mund te jene te pavarura ose ne grup specialistesh. Kur konstatohen shkelje kerkon e mban qendrim ndaj personave pergjegjes.
10. Mban lidhje te vazhueshme pune me klientet me te medhej si Sigurimet Shoqerore, Telekom, Dega e Tatim - Taksave, OSSH, Komisariati i Policise Rrugore, Ujesjellesi, etj, me ane te takimeve ku trajton probleme te ndryshme qe jane kostatuar gjate punes dhe bashkepunon me to per permiresimin e punes ne te ardhmen dhe permbushjen e te gjitha detyrimeve te ndersjellta qe rrjedhin nga zbatimi i akt-marveshjeve me keta kliente.
11. Ne bashkepunim me degen e burimeve njerzore organizon trajnime dhe testim per punonjesit e te gjitha zyrave postare per njohje e zbatim te Kontratave dhe Udhezimeve te Sherbimit financiar, rregullave dhe udhezimeve te nxjerra nga Posta Shqiptare e drejtoria e filialit.
12. Analizon e zgjidh ankesat e klienteve per sherbimet financiare, merr masat perkatese per permiresimin dhe korigjimin e mangesive dhe te metave duke nxjerr pergjegjesin konkrete te ketyre ankesave.
13. Ndjek e kontrollon zbatimin e orarit te punes e te sherbimit, disiplinën ne pune, zbatimin e rregullave te sigurise e ruajtjes M.N.Z-se.
14. Kontrollon zbatimin e grafikut te pageses se pensioneve per cdo zyre postare si dhe ate te pageses se pensioneve ne shtepi duke propozuar masa per permiresimin e punes ne funksion te rritjes se cilesise se sherbimit.
15. Merr ne dorezim nga zyra e protokollit e drejtorise se filialit Krahiner pagesat dhe urdher mbylljet e ardhura nga DRSSH-ja



- Rregjistron ato sipas zyrave postare te pageses se pensioneve. Ben dorezimin e urdher pagesave dhe urdher mbylljeve per cdo zyre postare.
- Merr ne dorezim nga zyrat postare urdher pagesat dhe urdher mbylljet e kthjera.
- Ben kthimin me shkrese zyrtare prane DRSSII-se te urdher pagesave dhe urdher mbylljeve te kthjera nga zyrat postare.

16. Ndjek korrespondencen me te tretet.

SPECIALIST I SHERBIMIT FINANCIAR

Varet dhe pergjigjet per kryerjen e detyrave te veta funksionale perpara Drejtorit Perkatës dhe K/Deget Perkatës dhe ka keto detyra dhe te drejta:

1. Ndjek dhe kontrollon cilesine e sherbimeve financiare per cdo ze dhe per cdo zyre postare ne perputhje me rregulloret e udhezimet e derguara nga Posta Shqiptare sh.a.
2. Ben perpjekje per rritjen e cilesise se sherbimeve financiare brenda filialit dhe kryen kontrole te organizuara e te befasishme ne deget ne varesi dhe zyrat postare te filialit.
3. Ndjek realizimin e treguesve ekonomik te te gjitha zerave te sherbimit financiar ne natyre dhe ne vlere.
4. Ndjek dhe kontrollon zbatimin e tarifave te sherbimit financiar ne sportele e zyra postare ne filial e deget ne varesi.
5. Drejton anen metodologjike, tekniko-profesionale e cilesine e kryerjes se sherbimeve te reja financiare ne zyrat postare te filialit dhe deget ne varesi.
6. Rakordon per probleme te ndryshme qe dalin gjate aktivitetit te perdritshem me zyrat postare dhe kerkon ndihmen perkatese per zgjidhjen e tyre.
7. Harton akt-rakordimet sipas datave te caknuara ne akt-marteveshje me te tretet sipas rregullave ne fuqi dhe informon here pas here per problemet qe dalin.
8. Ndjek cdo muaj marrjen e te dhenave nga Albtekom, OSSII, Tatime, Qendra Ekonomike e Bashkise per arketimin e kopshteve dhe Cerdheve, Nd/ja e Ujesjellesit, Njesite e Qeverisjes Vendore per pagesat e ndihmave ekonomike, invalide, etj. per arketimet/pagesat e faturave/detyrimeve mujore dhe merr masa per hedhjen e ketyre te dhenave (aty ku eshte e mundur) ne kompjuter prane zyrave postare te qytetit, me qellim lehtesimin e arketimit/pagesave.
9. Ndjek volumet e realizuara nga zyrat postare dhe ben akt-rakordin e arketimit te gjobave te policise rrugore me Komisaratin e Policise se Qarkut Tirane.

10. Zgjidh ankesat e klienteve per sherbimet financiare dhe marr masat perkatese per permiresimin dhe korigjimin e mangesive dhe te metave.
11. Ndjek dhe raporton ecurine e sherbimeve nepermjet evidencave ditore dhe mujore.

OPERATORE SHERBIMEVE FINANCIARE

Varet dhe pergjigjet per kryerjen e detyrave te veta funksionale perpara Drejtorit Perkates dhe K/Degeg dhe ka keto detyra dhe te drejta:

1. Kryen evidentimin çdo dite te te dhenave per pagesat e bera nga çdo zyre postare per pagesen e pensioneve ne baze te dokumentacionit qe vjen prane sektorit nga zyrat.
2. Hedh te gjitha veprimet per pagesat e pensioneve te çdo zyre postare ne ditarin e arkes.
3. Mbi bazen e ketyre te dhenave ndjek gjendjen ne fund te dites se çdo zyre postare dhe ben kontrollin e tyre me limitet e lejuara per keto gjendje.
4. Verifikon dhe rakordon ne fund te çdo muaji me arken e filialit levizjet e fondeve (te hyra dhe te dala) per çdo zyre postare.
5. Ben evidencen e volumit te sherbimit te pageses se pensioneve ne natyre e ne vlere dhe e dorezon ate prane deges ekonomike ne fund te çdo muaji.
6. Rakordon ne fund te çdo muaji me DRSSH per fondet e dhena nga DRSSH-ja dhe pagesat e kryera nga zyrat postare. Mbi bazen e ketyre te dhenave harton akt-rakordin mujor ku pasqyrohet detyrimi jone ndaj DRSSH-se ne fund te muajit qe mbartet si fond per tu perdorur per pagesat e pensioneve per muajin ne vazhdim.
7. Kontrollon evidencen e te ardhurave te raportuara nga çdo zyre postare te pageses se pensioneve dhe komisionin e pensioneve te shperndara per çdo muaj rakordon me DRSSH dhe pret faturen me TVSH per kete komision.
8. Ben kontroll ne zyrat postare te pageses se pensioneve mbi gjendjen e arkes dhe per probleme te ndryshme financiare.
9. Rakordon ne fund te çdo muaji me Zyren e Punes per fondet e dhena nga Zyra e Punes per pagesen e papunesise dhe per pagesat e kryera nga zyra postare. Mbi bazen e ketyre te dhenave harton akt-rakordin mujor ku pasqyrohet detyrimi i filialit ndaj zyles se punes ne fund te muajit qe mbartet si fond per t'u perdorur per pagesat e papunesise per muajin ne vazhdim.



10. Gjate muajit nxjerr te gjitha arketimet (si pensionet e dhene me teper, detyrimet qe duhet t'i mbahet pensionistit sipas urdher cdemumeve te ardhura nga DRSSH) duke mbajtur nje procesverbal me kete te fundit.
11. Ben çdo dite planifikimin e fondeve te nevojshme per pagesat e pensioneve per çdo zyre postare dhe rakordon me arken e filialit per shperndarjen e tyre sipas planifikimit.
12. Ben grumbullimin e listepagesave ditore te paguara per çdo zyre postare dhe i dorezon ato prane DRSSH-se duke kuadruar me ato per fondet e shpenzuara.
13. Rakordon per xhirimet e fondeve ditore prane DRSSH-se.
14. Ben kontroll ne zyrat postare te pageses se pensioneve lidhur me zbatimin e rregulloreve, akt-marveshjes, qarkoreve, cilesine e sherbimit dhe limitet e lejuara.
15. Raporton çdo dite prane Drejtorise se Sherbimeve Bankare e Financiare ne filial per fondet e terhequra nga sigurimet dhe pagesat e kryera nga zyrat postare per Filialin dhe degjet ne varesi.
16. Ndjek ecurine e sherbimit te legalizimit te dokumentave per MPJ dhe deshmitet e penalitetit per DPB nga çdo zyre postare, evidenton me vete volumet e realizuara dhe te ardhurat per keto sherbime, harton akt-rakordin me degen e finances te cilin e percjell çdo muaj ne Drejtorine e Sherbimeve Financiare e Bankare ne Drejtorine e Pergjithshme.
17. Zgjidh ankesat e klienteve per sherbimet qe mbulon dhe propozon tek pergjegjesi i sektorit te sherbimeve financiare masa konkrete per permiresimin ne vazhdimesi te mangesive te evidentuara.

KRYETAR I DEGES TEKNOLOGJISE INFORMACIONIT

Varet dhe pergjigjet per kryerjen e detyrave te veta funksionale perpara Drejtorit te Filialit dhe ka keto detyra dhe te drejta:

1. Mban pergjegjesi per mbarévajtjen e sistemeve informatike te Filialit . Mbikëqyr rrejetet kompjuterike dhe kualitetin e komunikimit. Udhëheq grupet e punës për eliminimin e defekteve te sistemeve kompjuterike e informatike. Zbaton dhe raporton për detyrat e ngarkuara nga Drejtoria e Filialit dhe nga Drejtoria e IT-se.
2. Planifikon dhe organizon menaxhimin e problemeve dhe incidenteve bashke me procedurat dhe sistemet informatike perkatese.
3. Ben Sugjerime paraprake te leverdisshmerise per futjen e sherbimeve te reja dhe investimeve te programuara si dhe per implementimin e teknologjive te reja ne perputhje me sherbimet e reja qe do te behen ne ne Filial.
4. Pergjigjet përpara Drejtorit te Filialit për kryerjen me përpikmëri te te gjitha detyrave teknike te Deges dhe përkatësishit .

- Analize dhe monitorim te sistemit si dhe instalon sistemet dhe nënsistemet
- Përmirësimi i performancës se sistemit.
- Riparimi i sistemit.
- Zbulimi dhe eliminimi i ndërprerjeve te sistemit.
- Tërësia e privilegjeve te aksesit ne sistemin, qe varet nga nevojat ne funksion teperdoruesit
- Përgjegjësi për funksionimin dhe ruajtjen e dhomës se Servereve
- Pajisja me dokumente për ndryshimet dhe zgjidhjet ekzistuese.
- Ndjekja e novacioneve te Teknologjisë se Informacionit
- Propozimi i zgjidhjeve te reja për upgrading e sistemit ekzistues
- Propozimi i zgjidhjeve te reja me teknologji te reja
- Mirëmbajtja dhe ruajtja e databazes lokale te Programit (Financa 5) etje.
- Zbulimi dhe eliminimi i ndërprerjeve ne funksionin e databazave lokale si dhe riaktivizimi i ruajtjes se te dhënave ne rast humbje te te dhënave.
- Te asistoi Teknikisht ne Rrjetin e IP Telefoneve ne raste defektesh apo avarish.

SPECIALIST I ADMINISTRIMIT TE TE DHENAVE

Varet dhe pergjigjet per kryerjen e detyrave te veta funksionale perpara Drejtorit Perkates dhe K/Deges Perkates dhe ka keto detyra dhe te drejta:

1. Planifikon dhe organizon menaxhimin e problemeve dhe incidenteve bashke me procedurat dhe sistemet informatike perkatese.
2. Përgjigjet për kualitetin dhe performancen e te gjithë aplikimeve informatike qe perdor Filiali.
6. Per dokumentacionin dales ne protokoll ne fillim behet regjistrimi ne librin e dorezimit te jashtem ku regjistrohen te gjitha dokumentacionet pasi te jene firmosur me pare nga Drejtuesi i Filialit duke i vulosur me pas ato dhe duke i shpene ne destinacionin perkates por gjithmone duke marre me pare firmen personave qe do marrin ne dorezim dokumentacionin perkates
7. Ne librin e korespondences (model 1) ruan me rregullsi nje rrethim kronologjik te dokumentacionit hyres dhe dales ku ne rastin



- dokumentacionit dales shenohet adresa ku dergohet ky dokument qe del nga institucioni.
8. Nuk evidentohet dhe nuk merret ne dorezim dokumentacioni me karakter te thjesht si psh: dokumenta per levizjen e mjeteve dhe te dokumenta te ketyre niveleve : evidenca periodike, dokumenti i llogative, dokumenti i magazinave dhe te tjera te llojeve si fatura, mandate arketimi dhe pagese, flete hyrjet ose flete daljet, flete udhetime nuk pefshihen ne listen e dokumentave me rendesi kombetare
 9. Hap dokumentacionin perkates vijues si me poshte:
 - Libri i korrespondences.
 - Libri i dorezimit te dokumentave te brendshme.
 - Libri i dorezimit te dokumentave te jashtme.
 - Libri i protokollit te mbledhjeve te drejtorise.
 - Hapja e dosjeve per arkivimin e dokumentave sipas degeve dhe sektoreve perkates.
 - Ne cdo dosje te hapur per deget dhe sektoret futen nendosje me numra indeksi per rendesine, lenden dhe rendesine e dokumentacionit.
 10. Mbyll dokumentacionin qe del jashte institucionit ne zarf ose ne pako (ku ne anen e majte shenohet adresa e derguesit dhe numri qe ka marre dokumentacioni ne regjistrin e korrespondences“model1“)ne mes te zarfit apo pakos shenohet adresa e plote e marresit dhe vuloset.
 11. Dosjet qe hapen ne inventare njehesohen me numet nje pas nje (rendor)per gjithe vitin.
 12. Merr masa per mirembajtjen e dokumentave te vendosura ne arshive ,per sigurimin ne pershtatje me kushtet e ruajtjes mbrojtjes nga demtimet, vjedhje, zjarri etj., si dhe zbaton rregullat per hyrjen ne arshive.
 13. Ne bashkpunimin me deget hap pasqyrat emertuese te dosjeve sipas qeshtjeve perkatese.
 14. Terheq nga deget te gjithe dokumentet qe kane mbaruar veprimtarine praktike dhe ben arkivimin e tyre. Cdo vit pergatit listat per asgjesimin e materialeve dokumentare qe ju ka kaluar afati dhe ja paraqet komisionit te ekspertimit i cili vendos per asgjesimin e tyre.

SHOFERI

Varet dhe pergjigjet per kryerjen e detyrave te veta funksionale perpara Drejtorit Perkates dhe Kryetarit te Deges Perkates dhe ka keto detyra dhe te drejta:

1. Ka ne ngarkim automjetin qe drejton dhe pergjigjet per ruajtjen dhe mirembajtjen e tij.
2. Levizja e tij do te dokumentohet me flete udhetimi e cila duhet te firmoset nga Pergjegjesi i Sigurimit Postar.
3. Flete udhetimi duhet ti dorezohet cdo fund muaji Pergjegjesit te Sektorit te Sigurimit Postar ne rast te kundert nuk do te furnizonet me tollona karburanti per muajin pasardhes.
4. Te marre masa per ta patur ne gadishmeri automjetin.
5. Per cdo detyre qe i ngarkohet nuk mund te largohet pa vene ne dijeni Krytarit te Deges se Burimeve Njerezore.
6. Te zbatoje disiplinen ne pune.
7. Nuk leviz automjetin kur nuk eshte ne gjendje te mire teknike. Cdo shkelje e ngarkon me pergjegjesi ligjore.

K/DEGES STANDARTEVE CILESISE – SIGURIMIT POSTAR

Varet dhe pergjigjet per kryerjen e detyrave te veta funksionale perpara Drejtorit Perkates dhe ka keto detyra dhe te drejta:

1. Te njohe Rregulloren e Sherbimit Baze Postar dhe te Sigurimit Postar, si dhe urdherat e udhezimet perkatese qe lidhen me kryerjen e detyres se tij.
2. Te njohe e te ndjeke nga afer zbatimin e marreveshjeve te bashkepunimit ndermjet Postes Shqiptare sh.a dhe Albtelekomit, K.E.SH-it per shperndarjen e faturave, si dhe klienteve te tjere potenciale, si dhe kontraten e bashkepunimit me TIA (Tirana International Airport).
3. Organizon sigurine e dergesave postare kolipostare nepermjet ndjekjes, kontrollit ne dinamike te operacioneve te perpunimit, ruajtjes dhe transportimit te tyre.
4. Te kontrolloje orarin e levizjes se dergesave postare te pergatitura per shperndaresit e zonave rurale, per shperndaresit e organizuar sipas zyrave postare te Tiranes, si dhe dokumentacionin shoqerues te dergesave ne nisje dhe mberritje.
5. Ndjek vijueshmerine e zbatimit te grafikeve te levizjes se mjeteve sipas filialeve, ne drejtim te sigurise se transportit te dergesave postare, kolipostare.
6. Investigon dhe ndjek tregun e sherbimeve postare me synim ruajtjen e aktivitetit te filialit nga nderhyrjet e konkurences.
7. Ushtron kontrole ne drejtim te zbatimit te rregullave, procedurave dhe akteve qe ndihmojne sigurine e sherbimeve postare.



8. Kontrollon ne vijshmeri funksionimin normal te aparaturave te sigurise dhe investigimit ne te gjithe sektoret e filialit.
9. Menaxhoo ne bashkepunim me degen ekonomike mjetet e transportit (motorra, bicikleta) dhe percakton e kontrollon normativat e harxhimit te karburantit duke llogaritur ngarkesen dhe distancat kilometrike, si dhe ne mbeshtetje te urdherave dhe udhezimeve te Drejtorise se Pergjithshme.
10. Organizon grafiket e kontrollit per shperndarjen dhe sigurine e objekteve postare ne bashkepunim me kontrolloret, duke percaktuar qarte zonat e kontrollit, duke kerkuar prej tyre evidentimin e problemeve dhe propozon ne drejtori masa konkrete per zgjidhjen e tyre.
11. Mban akt-kontrolle (ose proces verbale) te rregullta, per rastet kur evidentohen shkelje te rregullores se sherbimit postar te brendshem dhe nderkombetar ne procedurat e perpunimit dhe te shperndarjes, si dhe informon Drejtorine e Sigurimit Postar (ne Drejtorine e Pergjithshme) dhe Drejtorine e Filialit per cdo rast te shkeljeve te konstatuara.
12. Ben propozime konkrete ne lidhje me organizimin e punes dhe te sherbimit ne zone, bazuar ne normativen e objekteve postare si dhe siperfaqen e mbuluar me sherbim nga cdo shperndares.
13. Merr masa per ruajtjen e ambjenteve nga zjarri
14. Informon drejtorin per probleme te ndyshme qe cenojne mbarevajtjen e puneve ne filial.

15. Organizon, ndjek e kontrollon ne dinamika, operacionet e ruajtjes administrimit dhe transportit te vlerave monetare, ne perputhje me rregulloret dhe udhezimet perkatese.
16. Njeh rregullat, procedurat dhe aktet normative ku mbeshtetet aktivitetin Filiali dhe sigurimit postar.
17. Organizon, ndjek dhe kontrollon mbrojtjen e brendshme, mbrojtjen fizike te jashtme si dhe mbrojtjen nga zjarri.
18. Ndjek e kontrollon operacionet e perpunimit, ruajtjes dhe transportit te dergesave postare.
19. Organizon, ndjek dhe kontrollon ne dinamik operacionet e ruajtjes, administrimit dhe transportimit te vlerave monetate, ne perputhje te plote me rregulloret dhe udhezimet perkatese duke bashkerenduar punen me degjet e sherbimeve, policine e kontraktuar, policine e shtetit dhe organet e pushtetit vendor.
20. Ndjek, drejton e kontrollon ne dinamike perdorimin e sistemit elektronike te sigurise per shfrytezimin sa me me eficence te tyre dhe nderhyn per te marre masa ne kohen e duhur per sherbime mirmbajtje apo probleme te funksionimit te tyre.

21. Ndjek dhe drejton testimin dhe mbajtjen e sistemeve elektronike te sigurise ne eficence dhe organizon testimin e tyre jo me pak se nje here ne muaj.
22. Instukton e trajnon personelin e sektorit te sigurimit si dhe personelin punonjes qe ka ne perdorim butonet e alarm sinjalizimit si dhe ata qe meren me operacionet e levizjes se vlerave monetare.
23. Sipas situatave dhe detyrave qe merr, bashkërendon me organet e specializuara per ndjekjen e problemeve dhe proceseve te ndryshme qe mund te kene nisur per veprimet antiligjore te filialit.
24. Per te gjitha shkeljet dhe parregullsitet e kontatuara mban proces-verbal dhe informon shkreserisht drejtorine e filialit dhe drejtorine e sigurimit.
25. Bashkepunon me administraten per mbajtjen me eficence te paisjeve te mbrojtjes nga zjarri si dhe trajnon personelin per perdorimin e tyre, per evidentimin e burimeve te zjarit dhe veprimeve te para per shuarjen e tyre.
26. Ben identifikimin e rreziqeve ne objekt dhe aktivitete te filialit dhe propozon masa te reja sigurimi apo shtese.
27. Propozon dhe jep mendime per persosjen e punes, pergatit tema profesionale per sigurimin e aktiviteteve te filialit dhe personelit te tyre.
28. Realizon detyrat shtese qe i kerkohen ne menaxhimin e sigurise se Filialit.
29. Çdo shkelje e rregulloreve te postes dhe detyrave te marra nga Drejtoria e Sigurimit te Postes e vendos perballe pergjegjesive administrative sipas kontrates Kolektive dhe Individuale te punes.

SPECIALIST I CILESISE

Varet dhe pergjigjet per kryerjen e detyrave te veta funksionale perpara Drejtorit Perkatës dhe Kryetarit te Deges Perkatës dhe ka keto detyra dhe te drejta:

1. Njihet me procedurat, rregulloret dhe aktet qe normojne aktivitetin Standarteve Cilesise te Sherbimeve Postare.
2. Ndjek dhe kontrollon cilesin e sherbimeve postare, financiare dhe sherbimet e reja. Njeh situaten e kryerjes se sherbimeve, dobesit dhe difektet e cilesise, dhe ben rekomandimet perkatese.
3. Mban kontakte te vazhdueshme me Degen e Cilesise dhe Standarteve prane Drejtorise se Pergjithshme per organizimin e testeve te cilesise se sherbimeve.
4. Organizon punen per kryerjen e testeve duke plotesuar te gjitha kerkesat e tyre .
5. U ben te njohur zyrave postare rezultatet e testeve dhe propozon masa konkrete per permiresimin e treguesve cilesore.



6. Ndjek dhe kontrollon zbatimin e normativave të lejuara për objektet sipas përcaktimit të bërë nga Administrata të ndryshme Postare Nderkombëtare.
7. Organizon testimet e brendshme dhe përpunon materialet e grumbulluara dhe nxjerr rezultatet e testeve.
8. Kryen kontrolle të vazhdueshme të planifikuara dhe të befasishme, në të gjithë zyrat postare në lidhje me normativat e vijimit të objekteve postare dhe aplikimin e tarifave në fuqi.
9. Bashkëpunon me degen e shërbimeve për të siguruar cilësi të shërbimit dhe vijueshmëri të tij.
10. Evidenton reklamacionet e dala dhe të hyra për shërbimin postar dhe kolipostar në filial.
12. Evidenton e paraqet në fund të çdo muaji evidencën e reklamacioneve së bashku me një relacion ku paraqet problemet e evidentuara në drejtim të reklamacioneve e mardhenieve me klientet dhe ia paraqet ato drejtorisë së filialit.

SPECIALIST I SIGURISE

Varet dhe përgjigjet për kryerjen e detyrave të veta funksionale përpara Kryetarit të Degës së Sigurimit Postar dhe ka këto detyra dhe të drejta:

1. Njeh rregulloret, procedurat dhe aktet që normojnë sigurtinë në shërbimet që ofron Posta Shqiptare sh.a.
2. Bashkërendon punën me specialistet e Filialit dhe të Drejtorisë së Përgjithëshme, me synimin investigimin e incidenteve të sigurisë dhe parandalimin e cenimit të shërbimeve.
3. Ndjek / kontrollon/ investigon dhe raporton tek eprori i drejtpërdrejtë me shkrim në dinamike operacionet e përpunimit, ruajtjes dhe transportit të dërgesave postare, në përputhje me rregulloret dhe procedurat që synojnë parandalimin e dhunimit të tyre.
4. Ndjek, kontrollon/investigon dhe raporton me shkrim tek eprori i drejtpërdrejtë ecurinë e shërbimeve të ruajtjes dhe sigurisë fizike dhe zbatimin e kontratave përkatëse me partneret e sigurisë të kategorisë "A+B" dhe C, si dhe me ato të mirëmbajtjes të sistemeve GPS / GPRS të sinjalizimit dhe të vëzhgimit.
5. Me programe të miratuara/ose të befasishme/, ushtron kontrolle dhe procedurë investigimi në Zyrat Postare dhe Deget, në drejtim të zbatimit të rregulloreve, udhëzimeve dhe akteve normative të sigurimit.
6. Ndjek kontrollon/investigon/ informon tek eprori i drejtpërdrejtë për mbrojtjen e ambienteve të shërbimeve nga zjarri etj.

7. Ne procesin e investigimit, ben identifikimin e rreziqeve ne sherbimet, propozon masa te reja sigurimi me shkrim apo shtese tek eprori i drejteperdrejte, per te minimizuar ose eliminuar keto burime rreziku.
8. Kur konstaton shkelje te rregulloreve, udhezimeve,urdherave, vjedhje, demtime apo pasoja te tjera, informon me shkrim eproret dhe nderhyn per sqarimin dhe normalizimin e situates.
9. Pergatit programe(te miratuara nga eprori i drejteperdrejte) per ndjekjen dhe investigimin e problemeve te evidentuara si dhe mbi detyrat qe i ngarkohen.
10. Per shkeljet dhe parregullsit e konstatuara ne procesin e investigimit, ne sherbimet postare,finacjare, bankare etj ben dokumentimin e tyre dhe informon me shkrim eprorin per pasojat qe sjellin.

PERGJEGJES I SEKTORIT TE MIREMBAJTJES

Varet dhe pergjigjet per kryerjen e detyrave te veta funksionale perpara Drejtorit Perkates dhe ka keto detyra dhe te drejta:

1. Menaxhmi i mire dhe eficient i punonjesve te mirembajtjes dhe te pastrimit
2. Merr informacion nga zyrat postare per problemet e ndryshme qe mund te kene dhe organizon punen per riparimin e defekteve si zevendesim i xhamave te thyer, rregullim i bravave te demtuara, suvatim apo lysterje te ambjenteve qe kane nevojte etj punime mirembajtjeje.
3. Te zbatoje me korektesi detyrat qe merr nga filiali.
4. Jep llogari perpara Drejtorit te Sherbimeve Mbeshtetese per punet e kryera gjate dites.
5. Ne rast mungese te Drejtorit te Sherbimeve Mbeshtetese mer detyrat dhe raporton direkt tek Drejtori i Filialit.

KRYETAR I DEGES SE AUDITIT TE BRENDSHEM

Varet dhe pergjigjet per kryerjen e detyrave te veta funksionale perpara Drejtorit te Filialit dhe ka keto detyra dhe te drejta:

1. Harton planin vjetor te auditimit dhe ja paraqet per mitatim titullarit jo me vone se data 15 Nentor.
2. Harton deklaraten vjetore te misionit per qellimin, autoritetin dhe pergjegjesine e njesise se auditimit te brendshem, bazuar ne objektivat e Filialit, risqet e mundshme, nevojat e Drejtorit te Filialit dhe rezultatet e auditimeve te meparshme.
3. Harton planet 3 mujore te punes duke marre parasysht pushimet dhe mungesat e auditeve.



4. Vendos per rëndesinë e faktoreve riskues dhe përcakton relativitetin e tyre. Rëndësia e këtyre faktoreve reflektohet në gjykitnin rreth ndikimit relativ që duhet të ketë në selektimin e aktivitetëve për auditim. Përfshin informacione nga burime të ndryshme në procesin e vlerësimit të riskut.
5. Ndjek zbatimin e grafikut vjetor të auditimit.
6. Ndjek zbatimin e procesit të auditimit në përputhje me standartet për praktikën profesionale të auditit të brendshëm.
7. Siguron procedurat e shkruara për të udhëhequr stafin e auditit.
8. Zbaton e pasuron metodiken dhe normat e vecanta të auditimit. Zbaton ligjin nr. 9270, dt.23.04.2007 "Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik" dhe VKM nr. 345, datë 01.06.2004 'Për miratimin e manualit të procedurave të auditimit të brendshëm, të kodit etik për auditet e brendshëm dhe të kartës së auditimit të brendshëm publik'.
9. Për probleme specifike raporton dhe kërkon ndihmën e Drejtorit të Filialit dhe Drejtorisë së Auditimit pranë Drejtorisë së Përgjithshme.
10. Përgatit materiale përgjithëse dhe analiza periodike për rezultatet e auditimit si dhe propozon masa organizative e teknike në fushën e veprimtarisë ekonomike, financiare dhe të shërbimeve të zyrave postare të Filialit Tiranë dhe Degës Krujë të Postës Shqiptare sh.a. Përgatit raportet përmbledhëse 3 mujore dhe evidencat përkatëse.
11. Mban lidhje të ngushta me Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të Postës Shqiptare sh.a., ndjek rekomandimet e saj dhe shmang dublimet e panevojshme.
12. Mban lidhje të rregullta me degët e aparatit të Drejtorisë së Filialit për problemet që dalin në fushën e administrimit e ruajtjes së pronës dhe objekteve postare, si dhe për zbatimin e akteve ligjore e nënligjore në fuqi.
13. Propozon masa organizative e rregulla për përdorimin me kriter e administrimin rigoroz e të dokumentuar të vlerave materiale e monetare.
14. Për raste të vecanta mund të zgjase afatin e programuar të auditimit.
15. Gjatë auditimit merr mendime dhe propozime nga drejtuesit dhe punonjësit për problemet shqetësuese dhe i përfshin ato në program.
16. Përgatit përfundimet e auditimeve të kryera.
17. Mban regjistrin e auditimeve.
18. Kur zbulon përvetësim, shkelje e shpërdorime që formojnë vepra penale, bën kallzim për ndjekje penale pranë organeve përkatëse, ose kur nuk ka vepra penale, kërkon venien para përgjegjësisë të personave përgjegjës.
19. Mbyll dosjet e auditit.
20. Përzullon veprimet që janë në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, deri në shqyrtimin e tyre nga organi përkatës kompetent.

AUDIT

Varet dhe pergjigjet per kryerjen e detyrave te veta funksionale perpara Drejtorit te Filialit dhe Kryetarit te Deges Perkates dhe ka keto detyra dhe te drejta:

1. Zbaton e pasuron metodiken dhe normat e vecanta te auditimit. Zbaton ligjin nr. ne ligjin nr. 9270, dt.23.04.2007 "Per Auditimin e Brendshem ne Sektorin Publik" dhe VKM nr. 345, date 01.06.2004 'Per miratimin e manualit te procedurave te auditimit te brendshem, te kodit etik per auditet e brendshem dhe te kartes se auditimit te brendshem publik'.
2. Auditimi ka per detyre te zbatoje me perpikmeri programin e auditimit te plote apo tematik ne objektin e caktuar I dhe ne afatin dhe cilesine e kerkuar.
3. Sqaron problemet me personat e audituar, kerkon dhe le detyra shume afatshkurtera per plotesimin gjate kohes se auditimit te programuar, me qellim qe te hidhet drite e plote per parregullsine dhe shkeljet e ligjit apo procedurave te tjera.
4. Mban lidhje te ngushta me drejtuesin e njesise se auditimit dhe titullarin e Filialit dhe njofton here pas here per problemet e konstatuara, kerkon ndihmen e tij dhe te hallkave te tjera ne Filial.
5. Per probleme teknike apo ekonomike ka te drejte te kerkoje mobilizimin e specialisteve apo te eksperteve te fushave te ndryshme.
6. Kur afati I auditimit eshte I pamjaftueshem, lidhet me drejtuesin e njesise se auditimit, I paraqet arsyet apo veshtiresite e hasura, duke kerkuar ndihmen e nevojshme teknike dhe shtyrjen e afatit te percaktuar ne program.
7. Perpilon akt auditimin, dhe ua ben te njohur punonjesve te audituar. Brenda afatit prej 10 dite pune merr kundeshimet eventuale te te audituarve.
8. Harton memorandumine duke trajtuar ne menyre te permbledhur parregullsine e konstatuara, cileson shkelesit e rregullave apo ligjeve, si dhe propozon masa konkrete per secilin prej tyre, duke caktuar dhe afatet perkatese per eliminimin e te metave si dhe masen e cdemimit nga shkaktaret.
9. Nuk shkruan apo trajtoje probleme te pazgjidhura te cilat ne menyre taksative jane te detyrueshme per zbatim.
10. Jep rekomandime per sistemet kontrollit te brendshem ne filial, per pajtueshmerine e veprimtarise se subjektit te audituar me legjislacionin ne fuqi.
11. Mban qendrim konstruktiv duke synuar ne permiresimin e veprimeve dhe pecaktimin e menyrave per minimizimin e riskut.
12. Kryen auditimet ne menyre te pavarur nga ana funksionale dhe organizative.



13. Harton raporte te ndertmetme me kerkesen e drejtuesit te njesise se auditit dhe raporte konfidenciale ne rastin e zbulimit te veprave kriminale apo situatave te vecanta.
14. Jep argumenta per fillimin e nje investigimi. Paraqet raportin per ndalimin e veprimtarive te paligjshme.
15. Harton raportet e auditimit sipas kerkesave te manualit te procedurave te auditimit te brendshem, te kodit etik per auditet e brendshem dhe te kartes se auditimit te brendshem publik.
16. Harton memorandumun per informimin e titullarit lidhur me auditimet e kryera.
17. Harton procesverbalin ne rastin e veprave penale, mungesave, pervetsimeve apo shkeljet e disiplines financiare.
18. Korrigjon praktikat inefficente dhe inkurajon adoptimin e praktikave me te mira, duke mos u bere vete pjese e zbatimit te tyre.

DETYRAT DHE KOMPETENCAT E DREJTORISE OPERATIVE

DREJTORI

Varet dhe pergjigjet per kryerjen e detyrave te veta funksionale perpara Drejtorit dhe Zv/Drejtorit te Filialit dhe ka keto detyra dhe te drejta:

1. Drejton aktivitetin e struktures se Drejtorise Operative, duke zbatuar detyrat vjetore te ngarkuara nga Drejtoria e Filialit si dhe Drejtoria e Pergjithshme Posta Shqiptare sh.a.
2. Pergatit programe kontrolli per ndjekjen e problemeve mbi bazen e programit vjetor te miratuar nga Drejtoria e Filialit, si dhe detyrat qe i ngarkohen.
3. Pergatit programe kontrolli per ndjekjen e problemeve mbi bazen e detyrave te dhena nga Drejtoria e Pergjithshme Posta Shqiptare sh.a .
4. Bashkepunon me Drejtorite e tjera operative te Filialit per te siguruar cilesi te shetimit dhe vijuesmeri te tij.
5. Investigon, merr informacion, ben testimin e konkurrenteve ne tregun e lire, nxjerr rezultatet dhe i ben ato te njohura ne Drejtorite perkatese te Filialit.
6. Ndjek/kontrollon cilesine e sherbimeve postare, financiare dhe sherbimet e reja. Njeh situaten e kryerjes se sherbimeve, dobesite dhe difektet e cilesise, dhe ben rekomandimet perkatese.
7. Ndjek ne dinatnike zhvillimet bashkekohore ne sherbimet postare, financiare etj, me synim qe te sigurohen dhe te permirohen standartet

per te arritur tregues cilesie dhe besueshmerie ne te gjitha aktivitetet dhe operacionet qe kryen Shoqeria.

8. Pregatit planin mujor per specialistet e Drejtorise Operative.
9. Merr informacion me shkrim ditor, javor dhe mujor nga pergjegjesit e sektorit per punen e kryer nga specialistet.
10. Monitoron dhe investigon realizimin e shperndarjes se objekteve postare komform standarteve te caktuara dhe raporton ne Drejtorine e Filialit.
11. Ndjek dhe kontrollon aktivitetin e specialisteve duke evidentuar problematiken per cdo specialist.
12. Analizon ne menyre periodike problemet qe dalin dhe informon ne Drejtorine e Filialit dhe ne Drejtorine e Pergjithshme Posta Shqiptare sh.a.

PERGJEGJES SEKTORI

Varet dhe pergjigjet per kryerjen e detyrave te veta funksionale perpara Drejtorit Perkates dhe ka keto detyra dhe te drejta:

1. Pergatit programe kontrolli per ndjekjen e problemeve mbi bazen e programit mujor te miratuar nga Drejtori i Drejtorise Operative.
2. Pergatit programe kontrolli ditore per ndjekjen e problemeve mbi bazen e detyrave te dhena nga Drejtori i Drejtorise Operative.
3. Bashkepunon me Drejtorite e tjera operative te Filialit per te kontrolluar dhe verifikuar cilesine e kryerjes se sherbimit .
4. Ndjek zbatimin e orarit te punes se specialisteve dhe e evidenton ate.
5. Ne bashkepunim me Drejtorine e Shperndaresise ben planin e shperndarjes se detyrave ditore te specialisteve.
6. Perpunon informacion ditor dhe raporton me shkrim per Drejtorine e Filialit, Drejtorin e Drejtorise Operative dhe Qendren e Monitorimit te Drejtorise Pergjithshme.
7. Ne bashkepunim me Drejtorine e Shperndaresise kontrollon ne menyre te panderprere punen e kryer nga Kontrolloret dhe nga specialistet.
8. Raporton me shkrim ne cdo fund jave dhe muaji per punen e bere nga specialistet e Drejtorise Operative.
9. Pergatit praktiken e punes ditore dhe mujore te cdo specialisti.
10. Analizon ne menyre periodike problemet qe dalin dhe informon ne Drejtorine Operative.



SPECIALIST I DREJTORISE OPERATIVE

Varet dhe pergjigjet per kryerjen e detyrave te veta funksionale perpara Drejtorit dhe Pergjegjesit Sektorit perkates dhe ka keto detyra dhe te drejta:

1. Njeh Rregulloret e Sherbimit Baze Postar dhe procedurat e sigurise postare, qe normojne sherbimet qe ofron Posta Shqiptare sh.a.
2. Bashkerendon punen me specialistet e Drejtorise se Filialit, me synim investigimin e incidenteve te sherbimeve dhe parandalimin e cerimit te tyre.
3. Ndjek / kontrollon/ investigon dhe raporton tek eprori i drejteperdrejte me shkrim ne dinamike operacionet e perpunimit, ruajtjes dhe transportit te dergesave postare, ne perputhje me rregulloret dhe procedurat qe synojne parandalimin e dhunimit te tyre.
4. Ndjek kontrollon/investigon/ informon tek eprori i drejteperdrejte per mbrojtjen e ambienteve te sherbimeve nga zjarri etj.
5. Ne procesin e investigimit ben identifikimin e rreziqeve ne sherbimet, propozon masa te reja me shkrim apo shtese tek eprori i drejteperdrejte, per te minimizuar ose eliminuar keto burime rreziku.
6. Kur konstaton shkelje te rregulloreve, udhezimeve, urdherave, vjedhje, demtine apo pasoja te tjera, informon me shkrim eproret dhe nderhyn per sqarimin dhe normalizimin e situates.
7. Per shkeljet dhe parregullsite e konstatuara ne procesin operativ te kontrollit, ne sherbimet postare, finacjare, bankare etj ben dokumentimin e tyre dhe informon me shkrim eprorin per pasojat qe sjellin.
8. Kontrollon dhe verifikon dorzimin e flete-thirrjeve gjyqesore nga shperndaresit.
9. Kontrollon dhe verifikon dorzimin e objekteve postare te brendshme dhe te jashtme te shperndaresve ne terren.
10. Ne bashkepunim me Drejtorine e Shperndaresise teston mbi shperndarjen e faturave Albtelekom,CEZ ne zonat ku ka probleme.

DETYRAT DHE KOMPETENCAT E DEGES SE POSTES SH.A. KAVAJE

KRYETARI I DEGES

Varet dhe pergjigjet per kryerjen e detyrave te veta funksionale perpara Drejtorit te Filialit dhe ka keto detyra dhe te drejta:

1. Organizon,drejton,programon,bashkerendon dhe pergjigjet perpara Drejtorit te Filialit drejtpersedrejti per mbarvajtjen, zhvillimin,zgjerimin dhe ngritjen cilesore e sasiore te sherbimeve postare e financiare etj ne dege.
2. Organizon dhe drejton gjithe aktivitetin ekonomiko – financiar,mbarvajtjen e sherbimeve ne te gjithe Dege e zyrat postare ne varesi.
3. Organizon e drejton analizat periodike ekonomiko-financiare te Deges
4. Drejton dhe organizon punen per hartimin e projekt-programit-ekonomiko financiar dhe projektin per treguesit normative e cilesore te sherbimeve net e gjithe treguesit e tyre dhe e prezanton ate ne Drejtorine e Filialit.
5. Organizon punen per raportimin ne kohe,saktesi dhe cilesi te detyrave qe caktohen nga Drejtoria e Filialit si dhe organet e tjera me te larta.
6. Organizon kontrollin e zbatimit te programit ekonomiko-financiar, rregulloret e sherbimeve postare dhe financiare, cilesine, shpejtesine e saktesine e tyre si dhe zbatimin e drejte e ne kohe te vendimeve, urdheresave e udhezimeve ne fuqi.
7. Organizon dhe pergjigjet per miradministrimin e vlerave materiale e monetare, sherbimin statistikor dhe kontabilitetin ne dege ne perputhje te plote me aktet ligjore e nenligjore ne fuqi.
8. I propozon Drejtorise se Filialit kandidatet per emerime ne vendet vakante.
9. I propozon Drejtorise se Filialit dhenien e masave disiplinore si dhe largimet nga puna per punonjesit ne administraten e tij.
10. Organizon punen per zbatimin me korrektesi te plote te struktures organizative ne Filial plotesimin e organikave me punonjes te pershtatshem sipas aftesive ,nivelit dhe profilit arsimor duke bere respektimin e tabelës se pagave te miratuara nga Keshilli Mbikqyres.
11. Organizon punen per reklamimin dhe tregetimin e te gjitha sherbimeve postare e financiare qe kryen *Posta Shqiptare * nepermjet medias shkruar dhe asaj vizive



12. Siguron bashkpunim e bashkeveprim me partneret kryesore, Kesh, Alblekom, I.S.K.SH, etj ne Dege per mirfunksionimin e aktiviteve te sherbimeve postare dhe financiate.
13. Organizon punen per administrimin dhe ruajtjen e arkivit te Deges, si dhe pergjigjet per mirzbatimin e rendit te brendshem ne pune per foramin e disciplines dhe ruajtjen e administrimit te vlerave monetare, dokumentare e materialeve konforme rregullores perkate e si dhe akteve ligjore e neligjore ne fuqi.
14. Organizon kontrole te befasishme tematike si dhe miraton, ndjek e analizon programet e kontroleve te befasishme ne zyrat postare.
15. Therret ne raport sipas problemeve te gjitha punonjesit e varesise ne Dege dhe sipas pergjegjesive e pasojave, propozon masat perkatese per miratim ne Drejtorine e Filialit ne perputhje me Kontraten Kolektive dhe Kodin e Punes.

KRYETAR I ZYRES SHERBIMEVE DHE MARKETINGUT

Varet dhe pergjigjet per kryerjen e detyrave te veta funksionale perpara Kryetarit te Deges dhe ka keto detyra dhe te drejta:

1. Organizon, ndjek, kontrollon dhe pergjigjet per ecurine e sherbimeve postare, telegrafonik ne Filialin e Postes Tirane. Drejton anen metodologjike te kryerjes se ketyre sherbimeve ne deget, sektoret dhe zyrat postare ne vartesi te filialit.
2. Ndjek dhe kontrollon zbatimin e rregullores se sherbimeve ne deget, sektoret e zyrat postare, udhezimet e dala nga Drejtoria e Shoqerise per zbatimin e marveshjeve e kontratave te lidhura me kompani, firma e organizata te ndryshme.
3. Ndjek e kontrollon hartimin e programeve mujore te punes se degeve dhe te sektoreve qe ka ne vartesi.
4. Merr pjese ne hartimin e programit ekonomik –financiar te filialit dhe mbas miratimit organizon punen per detajimin e tij.
5. Pergjigjet per realizimin e treguseve te miratuar te programit, per çdo dege sektor e zyre postare.
6. Ndjek realizimin e treguseve ekonomik dhe te sherbimeve ne menyre periodike.
7. Analizon çdo muaj progresivisht gjendjen aktuale te sherbimeve, tendencat, faktoret dhe prespektiven e sherbimeve.
8. Ben perpjekje per marrjen e sherbimeve te reja dhe analizon nese ka sherbime te humbura, faktoret qe kane ndikuar dhe mundesite per rikuperim.

9. Organizon kontrolle te pavarura dhe nen grup pune per cilesine e kryerjes se sherbimeve ne Dege.
10. Ne bashkpunim me deget e sektoret studion ngarkesen per çdo zyre postare apo vend pune dhe mbi bazen e rezultateve te nxjerra ben propozimin per hapjen ose mbylljen e zyrave postare ne qytet, qender komune e fshat fundor, per shtimin ose shkurtimin e vendeve te punes me qellim permirsimin e treguave ekonomiko –financiar dhe ato cilesor te Deges.

SPECIALIST SHERBIMESH

Varet dhe pergjigjet per kryerjen e detyrave te veta funksionale perpara Kryetarit te Zyres se Sherbimeve dhe Marketingut dhe ka keto detyra dhe te drejta:

1. Ndjek zbatimin e Rregullores se Sherbimit Baze Postar si dhe te gjitha urdherave dhe udhezimeve qe dergohen nga Posta Shqiptare sh.a.(Drejtoria e Sherbimit Postar).
2. Ben perpjekje per ritjen e cilesise se sherbimeve postare brenda filialit dhe kryen kontrolle te organizuara e te befasishme ne deget dhe zyrat postare ne vartesi te filialit.
3. Ndjek zbatimin e kontratave te lidhura per sherbimet e biznesit qe ofron Filiali i Postes Tirane.
4. Ndjek realizimin e treguesve ekonomik te te gjitha zerave te sherbimit biznesit ne natyre e ne vlere.
5. Kontrollon zbatimin e urdherave dhe udhezimeve qe dergohen nga Posta Shqiptare sh.a. ne dege per sherbimin e biznesit.
6. Ndjek dhe kontrollon zbatimin e tarifave te sherbimit postar ne sportele e zyra postare .
7. Mban lidhje me zyra postare te deges per mbarvajtjen e punes ne sherbimin postar dhe ndihmon ne zgjidhjen e problemeve.
8. Mban evidence mujore mbi shitjen dhe gjendjen e kartave telefonike duke bere dhe analizen perkatese per permirsimin e punes.
9. Ushtron kontrolle ne zyra postare per reklaminin e sherbimeve dhe artikujve te biznesit.
10. Ndjek dhe harton proces-verbalin mujor me Albtelekomin per shlyerjen e detyrimeve per sherbimin telefonike

KRYETAR I ZYRES EKONOMIKE

Varet dhe pergjigjet per kryerjen e detyrave te veta funksionale perpara Kryetarit te Deges dhe ka keto detyra dhe te drejta:



1. Siguron zbatimin e ligjshmerise dhe rregullave te percaktuara per administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale dhe monetare.
2. Mban lidhje te rregullta me Drejtorine e Filialit per problemet qe dalin ne lidhje me zbatimin e ligjshmerise financiare, administrimin e pasurise se filialit per parandalimin e veprimeve qe jane ne kundërshtim me statusin e Shoqerise dhe dispozitat ligjore ne fuqi.
3. Ne bashkepunim me degët operative ne filial punon per hartimin e projekt-programit ekonomiko-financiar me synim rritjen e te ardhurave paksimin e shpenzimeve.
4. Pergjigjet per dergimin ne afat e me cilesi te te gjitha te dhenave te percaktuara (bilancin vjetor e ate periodik, evidencen e realizimit te te ardhurave ,shpenzimeve ,fitimit) si dhe per çdo te dhene tjeter qe kerkohet nga Shoqeria.
5. Pergjigjet per zbatimin e planit kontabel dhe udhezimeve te derguara nga Shoqeria per kete qellim.
6. Organizon dhe drejton punen per nxjerrjen e bilancit kontabel ne afatet e caktuara duke pergatitur relacionin shpjegues.
7. Ne bashkepunim me Zyren e Sherbimeve e Marketingut ndjek zbatimin e tarifave e çmimeve te derguara nga Shoqeria.
8. Ndjek ne vazhdimesi gjendjen e debi-kredive i analizon çdo tremujor duke percaktuar dhe masa per paksimin e tyre.
9. Organizon punen per kryerjen e gjithe inventareve fizike (nje here ne vit) duke propozuar perberjen e komisioneve si dhe komisionin e asgjesimit te materjaleve qe propozohen e miratohen per jashte perdorimit.
10. Mban ditarin e pergjithshem te mjeteve kryesore dhe ben llogaritjen e amortizimit tremujor e vjetor.
11. Pergatit relacionin, pasqyrat permbljedhese te rezultateve te inventarizimit dhe ja percjell Drejtorise se Filialit me sistemin e propozimeve te materialeve per jashte perdorimit.
12. Ne mbështetje te Udhezimit nr.3,date 19.02.1996 te K.M. "Per blerjet me vlera te vogla " kryen detyren e kryetarit te komisionit me komisionin e miratuar nga titullari i Filialit duke pergatitur urdher prokurimi.
13. Zbaton te gjitha detyrat qe merr nga Shoqeria dhe Drejtori i filialit.

LLOGARITAR – ARKETAR

Varet dhe pergjigjet per kryerjen e detyrave te veta funksionale perpara Kryetarit te Zyres Ekonomike dhe ka keto detyra dhe te drejta:

1. Ben regjistrimin dhe kontabilizimin e veprimeve ditore te arkës ne leke e valute, duke i pasqyruar sipas llogarive perkatese.
2. Perpilon mandat- pagesat ditore per te gjitha pagesat e kryera nga arka ne leke e valute.
3. Ndajne dokumentat e urdher- derdhjet sipas sherbimeve: Telekom, Kesh, Tatime, Sigurime shoqerore, Gjoha policie, Uje, kopesht e cerdhe, shkolle, Hermes Levend e te tjera sherbime te kryera nga sportelet e zyrave postare
4. Mban veprimet e arkës per gjithë veprimet e muajit arketime e pagesa.
5. Kryen inventarin e arkës njehere ne muaj se bashku me llogaritimin e pare dhe ate te mardhenieve me sportelet.
6. Kryen administrimin e materjaleve me vlere si pulla poste, zarfa te ndryshem, karta telefonike, leter fotokopje etj dhe nxjer gjendjen ne fund te tre mujorit
7. Mban librin e pulles
8. Mban llogarine 423 mbi shperndarjen e fondeve per pensionet sipas grafikut te miratuar nga Kryetari i Degës
9. Dokumenton dhe shperndan sipas zyrave postare bazen materjale te marre nga Filiali

LLOGARITAR KOSTO – NORMATIVE

Varet dhe pergjigjet per kryerjen e detyrave te veta funksionale perpara Kryetarit te Zyres Ekonomike dhe ka keto detyra dhe te drejta:

1. Organizon evidencen statistikore te shpenzimeve sipas grup sherbimeve per te llogaritur nje kosto reale.
2. Ndjek ne menyre periodike evidencat e shpenzimeve per cdo lloj sherbimi dhe e dergon ate ne sektorin e statistikes.
3. Kryen kronometrimin dhe fotografimin e proceseve te punes per cdo produkt te sherbimit egzistues dhe per produktet e reja
4. Llogarit koston per cdo produkt postar e financiar , te perballueshem per klientin.
5. Grumbullon dhe informon mbi gjendjen e te gjithë treguesve qe kane te bejne me koston e produktit.
6. Ndjek dhe evidenton cdo ndryshim te elementeve te koston per te pasqyruar ndryshimin ne koston e produktit duke informuar Drejtorin e Filialit.
7. Percakton rezultatet analitike te elementeve te koston dhe vleresimin e rezervave per cdo element te koston se produktit.



DETYRAT E KRYETARIT TE ZYRES POSTARE

Varet dhe pergjigjet per kryerjen e detyrave te veta funksionale perpara Drejtorit Perkates dhe Pergjegjesit Perkates dhe ka keto detyra dhe te drejta:

1. Te njohë Rregulloren e Shërbimit Postar, Rregulloren e Brendshme të "Posta Shqiptare" sh.a., si dhe urdherat dhe udhëzimet e drejtorisë së filialit, që lidhen me kryerjen e shërbimeve postare, financiare dhe biznes në zyrën postare.
2. Ndjek, evidenton dhe analizon çdo ditë realizimin e programit sipas zerave të shërbimit në zyrë postare dhe merr masa për realizimin e tyre.
3. Përpilon evidencat statistikore operative dhe mujore të shërbimeve në natyrë, volum dhe të ardhura dhe i dorëzon ato brenda afatëve në Degen e Zyrave Postare të Qytetit Tirane.
4. Te njohë tarifën e shërbimit dhe mënyrën e tarifimit të objekteve dhe shërbimeve të tjera, si dhe mban përgjegjësi për afishimin e tyre në sportel.
5. Arketon dhe përpunon vlerat monetare të sporteve të zyrës postare sipas turneve, bën përpunimin dhe pasqyrimin e tyre në librin e arkës së zyrës postare.
6. Te njohë dhe zbatojë grafikun e levizjes së vlerave monetare dhe të vijimit të dërgesave postare në zyrën postare.
7. Te njohë dhe përdorë programet baze kompjuterike të shërbimit në poste dhe të mbajë kontakte të vazhdueshme me specialistin e IT, pranë drejtorisë së filialit lidhur me gadishmerinë e rrjetit informatik.
8. Njeh dhe plotëson rregullisht të gjitha nevojat e zyrës postare për formulare të shërbimit dhe arrijtë të biznesit.
9. Kontrollon ndërrimin çdo ditë të vulës datore dhe vulave të tjera të shërbimit dhe vulosjen e dokumentave që përdoren gjatë orarit të shërbimit.
10. Te njohë dhe plotësojë sakte, qarte dhe pastër të gjitha formularet që përdoren në shërbime, etiketat e shërbimit, reklamacione, lajmerim-marrjet etj.
11. Kontrollon çdo ditë paraqitjen në punë të punonjësve të zyrës postare, bën shpërndarjen e tyre në turne dhe evidenton rregullisht listë prezencën e tyre.
12. Paraqet çdo 15 ditë pranë K/Degës së Zyrave Postare të Qytetit Tirane, listë prezencën e punonjësve.
13. Harton për çdo muaj grafikun e turneve punës në zyrën postare dhe i dërgon ato për miratim në Degen e Shërbimeve të Filialit.

14. Mban proces-verbale per shkelje te rregullave gjate kryerjes se sherbimit nga punonjesit ne zyra postare dhe merr masa te permiresimit e tyre.
15. Harton dhe paraqet per miratim grafikun e lejeve te zakonshme prane K/Deges se Zyrave Postare te Qytetit Tirane, duke marre masa per zevendesim te punonjesve dhe organizim te brendshem te punes.
16. Organizon punen dhe pergjigjet per perpunimin dhe vijimin çdo dite te objekteve postare nga zyra postare ne posten qendrore Tirane.

DETYRAT E PUNONJESIT SHERBIMIT NE SPORTEL

Varet dhe pergjigjet per kryerjen e detyrave te veta funksionale perpara Pergjegjesit Perkates dhe Kryetarit te Zyres Perkatese dhe ka keto detyra dhe te drejta:

1. Te njohe Rregulloren e Sherbimit Postar, Rregulloren e Brendshme te "Postes Shqiptare" sh.a., si dhe urdherat dhe udhezimet e Drejtorise se Filialit, qe lidhen me kryerjen e sherbimeve postare, financiare dhe biznes ne zyren postare.
2. Te njohe dhe zbatoje me korrektesi kodin e etikes ne marrredheniet me klientet ne sportel.
3. Ndjek dhe evidenton çdo dite realizimin e programit ne natyre, volum dhe te ardhura sipas zerave te sherbimit ne sportelin ku punon.
4. Te njohe tarifat e sherbimit dhe menyren e tarifimit te objekteve dhe sherbimeve te tjera, si dhe mban pergjegjesi per zbatimin e sakte te tyre.
5. Ne fund te turnit perpunon vlerat monetare te sportelit, i rregjistron ato ne ditaret perkates sipas llojit te sherbimit dhe i derdh ne arken e zyres postare.
6. Te njohe dhe perdore programet kompjuterike te postes per sherbimet qe kryhen ne sportel.
7. Te njohe, te perdore dhe te mirembaje vulat e sherbimit ne sportel si dhe te beje çdo dite ndrrimin e vules datare dhe vulave te tjera te sherbimit dhe vulosjen e dokumentave qe perdoren gjate orarit te sherbimit.
8. Te rregjistroje ne rregjistrat e pranimit te objekteve postare, kolipostare, sherbimin e pershpjtuar zyrtar sipas llogarive te tyre, te gjitha objektet e pranuar brenda orarit te sherbimit.
9. Te njohe dhe plotesoje sakte, qarte dhe paster te gjitha formularet qe perdoren ne sherbime, etiketat e sherbimit, reklamacione,



- lajmerim-marrjet, liste dergesat, flete udhëtimet e kolipostes, liste dorezimet e dergesave postare, etj.
10. Zbaton me korrektesi urdherat dhe udhëzimet e dhena nga përgjegjësja e zyrës postare për turnet, orarin, llojet e shërbimit dhe disiplinën në punë.
 11. Të mbajë proces-verbale e vezhgese kur konstatohen paturbulsi.
 12. Të njohë dhe të zbatojë rregullat e furnimit të dergesave postare, rregjistrimin e tyre në librat e dorezimit dhe vijimin brenda ditës të objekteve të pranuar në sportel kundrejt nënshkrimit përkatës.
 13. Zbaton grafikun e turneve të punës të hartuara nga përgjegjësja e zyrës postare dhe të miratuar nga Dega e Shërbimeve të Filialit.

DETYRAT E SHPERNDARESIT TE OBJEKTEVE POSTARE

Varet dhe përgjigjet për kryerjen e detyrave të veta funksionale përpara Kryetarit të Degës
Përkatës dhe ka këto detyra dhe të drejta:

1. Të zbatojë Rregulloren e Shërbimit Postar, Rregulloren e Brendshme të "Postës Shqiptare" s.h.a., si dhe urdherat dhe udhëzimet e drejtorisë së filialit, që lidhen me kryerjen e shërbimit të shpërndarjes së objekteve postare.
2. Merr në dorezim objektet e porositura, objektet me lajmërim-marrje, fletet e komunikimit gjyqësor dhe urdher-pagesat që janë të regjistruara në librin e dorezimit, si dhe objektet e thjeshta kundrejt nënshkrimit të tij të plote.
3. Dorezon objektet e thjeshta dhe të porositura marrësit në adresën e shënuar në zarf kundrejt nënshkrimit të plote (emer, mbiemer dhe firmë) dhe në rast se personi nuk ndodhet i dorezohet të afërmit që është në moshë madhore, kundrejt nënshkrimit të plote si dhe shënimit të lidhjes familjare që ka me marrësin.
4. Për objektet postare me lajmërim-marrje, fletet e komunikimit gjyqësor dhe urdher-pagesat, pasi nënshkruhen me nënshkrim të plote nga marrësi, bëjnë kthimin e tyre në sektorin e përfundim për t'u vijuar tek dërguesi.
5. Objektet që nuk dorezohen për arsye të ndryshme dhe për të cilat është lënë në adresën e tyre lajmërimi, shpërndarësi bëjnë kthimin e tyre me shënimin për arsyen e mosdorezimit.

6. Ne fund te dites se punes shperndaresi ben dorezimin e fletes se librit te dorezimit te objekteve postare te dorezuara. Gjithashtu ben dorezimin edhe:
 - E lajmerim-marrjeve per objektet postare
 - E defteses per lajmerim dorezimi te paketave dhe kolive
 - E fletes se komunikimit gjyqesor
 - E lajmerimit per mberritje te urdher pagesave nderkombetare
 - E defteses per njoftim mberritje te urdher pagesave postare
 - Te objekteve qe kane mbetur pa dorezuar, duke vendosur ne etiketen model E10 dhe CN15 arsyen e mosdorezimit.
7. Te silltet me kulture, korrektesi e cilesi sherbimi ne marredheniet me klientet.

DETYRAT E PUNONJESIT TE PERPUNIMIT

Varet dhe pergjigjet per kryerjen e detyrave te veta funksionale perpara Pergjegjesit Perkates dhe Kryetarit te Zyres Perkatese dhe ka keto detyra dhe te drejta:

1. Te njohe Rregulloren e Sherbimit Postar, Rregulloren e Brendshme te "Postes Shqiptare" sh.a., si dhe urdherat dhe udhezimet e Drejtorise se Filialit, qe lidhen me kryerjen e sherbimeve postare ne sektorin e perpunimit dhe zyren postare.
2. Te njohe dhe zbatoje me korrektesi kodin e etikes.
3. Ndjek dhe evidenton çdo dite objektet e nisura ne destinacione te ndryshme sipas list dergesave.
4. Te njohe tarifat e sherbimit dhe menyren e tarifimit te objekteve dhe ben kontrollin e tyre.
5. Merr me list dergese kundrejt nenshkrimit objektet e pranuar ne sportel, ben kontrollin e tyre dhe behet barrikade per ato te pranuar jashte Rregullores se Sherbimit Postar.
6. Ne fund te turnit mban proces verbal per ecurine e sherbimit dhe problematiken e tij.
7. Te njohe, te perdore dhe te mirembaje vulat e sherbimit ne sektor si dhe te beje çdo dite ndrrimin e vules datare dhe vulave te tjera te sherbimit dhe vulosjen e dokumentave qe perdoren gjate orarit te sherbimit.
8. Te njohe dhe te kontrolloje plotesimin e te gjitha formulareve qe perdoren ne sherbime si reklamacione, lajmerim-marrjet, liste dergesat, flete udhetimet e kolipostes, liste dorezimet e dergesave postare, etj.



9. Zbaton me korrektesi urdherat dhe udhezimet e dhena nga pergjegjesja e zyres postare per turnet, orarin, dhe disiplinen ne pune.
10. Te mbaje proces-verbale e vzhgesa kur konstatohen parregullsi dhe te ktheje ne kohe ato te ardhura.
11. Ndjek me perpikmeri grafikun e dorezimit te postes te miratuar nga Drejtoria e Filialit.

SHOQUERUES I VLERAVE MONETARE

Varet dhe pergjigjet per kryerjen e detyrave te veta funksionale perpara K/Deges Perkatese dhe ka keto detyra dhe te drejta:

1. Te njohe dhe te zbatoje rregulloret dhe aktet normative ku bazohet aktiviteti i transportit te vlerave monetare.
2. Njeh dhe i nenshtrohet rigorozisht rregullave te ruajtjes se sekretit.
3. Merr ne dorzim vlerat monetare si koli, pa bere verifikimin e tyre ne permbajtje si dhe dokumentet perkatese.
4. Kontrollon kolin nga pikpamja formale dhe kur konstaton parregullsi (*shenja grisje, shqepje, te hapura, vula te parregullta etj.*) refuzon marrjen ne dorzim dhe njofton eproret e tij per marrjen e masave perkatese.
5. Ploteson dokumentacionin e levizjes se vlerave monetare, duke bere verifikimin e permbajtjes per numerimin e kolive.
6. ~~Kryen dorzimin e vlerave monetare ne destinacionin perkates, kundrejt evidentimit ne dokumentacionin perkates, qe verteton marrjen e vlerave monetare ne dorzim.~~
7. Gjate veprimave me vlera monetare ne zyrat postare te Filialit, te veprone me shpejtesi, te mos qendroje ne pritje dhe te mos kryej veprime qe s'kan te bejne me detyren e tij funksionale.
8. Mban pergjegjsi te plote materiale dhe penale per mos dorezimin e vlerave monetare ne destinacion sipas vleres se percaktuar ne dokumentat e pergatitura nga nisesi, si dhe ne mungesat qe vertetohen ne permbajtjen e kolive, kur ato dokumentohen se gjate kontrollit vrchen shenja grisje, shqepje, vula te demtuara ose mhyllje te parregullta etj.
9. Kur konstatohen koli te parregullta ato dokumentohen me proces-verbale te veçante ne prani te shoqeruesit te vlerave, i cili mban pergjegjesi per diferencat eventuale qe vertetohen nga maresi. Kur per çdo arsye, nuk pranohet te behet dorzimi nga secila pale, vlerat monetare rikthehen ne zyren e nisesi.
10. Para nisjes ben kujdes per ruajtjen e sekretit te levizjes. Komunikimi te behet sipas rregullave e udhezimeve te percaktuar (te koduar).
11. Ndryshon ne koordinim te plote me Kryetarin e Deges te Sigurimit dhe pergjegjesin e eskortes se shoqerimit, sa here e shikon te

- arsyeshme intinerarin e levizjes si dhe oren per secilen zyre postare, ne funksion te sigurimit te vlerave monetare.
12. Eviton intinerarin e levizjes ne ato vende ku ka grumbullime, mitingje etj.
 13. Çdo dite para dhe mbas perfundimit te punes, informon eprorin etij, per fillimin dhe mbarvajtjen e punes apo problemet e dinamikës se perditeshme.
 14. Kur gjate udhetimit automjeti peson difekt, njofton eproret e tij, behet ruajtja e mbrojtja e vlerave monetare ne bashkpunim me eskorten shoqeruese. Kur gjykohet e arsyeshme, kerkohet ndihma nga zyra postare me e afert e cila merr vlerat monetare ne ruajtje.
 15. Para ndalimit ne zyren postare kontrollon ambjentin rretheqark, punonjesit e eskortes shoqeruese te jene ne pozicionet e tyre te gadishmerise, pastaj te veprojne me vlerat monetare.
 16. Ne rast agresioni e sulmi, jepet ndihma e pare nese eshte e nevojshme, sinjali i alarmit komisarariatit te policise me te afert, shkurt per ngjarjen e vendndodhjen, njoftohen eproret dhe qendra operative e policise se kontaktuar, ruhet vendi i ngjarjes, ndihmohen organet e policise me informacione te hollesishme.
 17. Çdo shkelje e rregulloreve te Filialit dhe detyrave te marra nga Kryetari i Deges te Sigurimit, e vendos shoqeruesin e vlerave monetare perballe pergjegjesive administrative sipas Kontrates Kolektive dhe Individuale te Punes.

KOMISIONI

Marita Tollkuçi
 Gezim Shtini
 Flora Beqiraj
 Arta Kazazi
 Mirela Karapici
 Drita Bakiu
 Afrim Haxhia
 Muhamer Çipi
 Agim Koci
 Zylfie Hajdari
 Festim Zito
 Isak Tema

Kryetare
 Anetar
 Anetar
 Anetar
 Anetar
 Anetar
 Anetar
 Anetar
 Anetar
 Anetar
 Anetar
 Anetar



